



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Sigurinë Kombëtare*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 3.3.2021, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Vijimi i shqyrtimit nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”.

**Marrin pjesë:**

Ermonela Felaj, Elona Gjebrea, Antoneta Dhima, Artemis Malo, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Ylli Shehu, Myslim Murrizi, Luan Duzha, Arben Elezi, Edmond Rrushi dhe Nimet Musaj.

**Mungojnë:**

Paulin Sterkaj, Alban Zeneli, Anduel Xhindi, Sadi Vorpsi, Luan Harusha, Lefter Maliqi dhe Edmond Stojku.

**Të ftuar:**

Julian Hodaj – Zëvendësministër i Brendshëm

Elena Pici – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Brendshme

Fatmir Shehu – Drejtor Juridik në Ministrinë e Brendshme

Klajdi Karameta – Zëvendësministër i Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Ermonela Felaj** – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë!

Meqenëse kuorumi është i plotë, fillojmë mbledhjen e Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Sot, si pikë të parë të rendit të ditës do të kemi vijimin e shqyrtimit nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”. Relatore e këtij projektligji është zonja Malo.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”. Relatore e këtij projektligji është kolegja Elena Xhina.

Për pikën e parë të rendit të ditës të pranishëm nga Ministria e Brendshme janë zoti Julian Hodaj, zëvendësministër, sekretarja e Përgjithshme zonja Elena Pici dhe drejtori Juridik në Ministrinë e Brendshme zoti Fatmir Shehu.

Pa humbur kohë fillojmë me pikën e parë, pasi dje i lamë disa detyra grupit të punës, për të përmblytur përmbajtjen e disa neneve për të pasur një zbardhje korrekte të përmbajtjes së projektligjit.

Po filloj me nenet 15 dhe 16 të projektligjit, për të përmbajtjen e të cilëve ramë dakord gjatë mbledhjes së djeshme, por thjesht për rekorde të kësaj mbledhjeje po jua lexoj edhe një herë përmbajtjen e secilit prej këtyre neneve.

Neni 15 “Ministri”.

“Ministri ka këto përgjegjësi dhe kompetenca:

- a) harton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të veprimtarisë së Gardës;
- b) përcakton drejtimet strategjike dhe objektivat e Gardës;
- c) i kërkon drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës të raportojë për kryerjen e detyrave, si dhe për çështje të veçanta që lidhen me sigurinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje;
- ç) ushtron inspektim nëpërmjet strukturave të sistemit të ministrisë;
- d) nxjerr akte administrative në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Gardës, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

dh) garanton bashkëpunim ndërmjet Gardës dhe strukturave të tjera të sistemit të ministrisë, institucioneve të zbatimit të ligjit, si dhe institucioneve homologe të vendeve të tjera në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara;

Germa “e”, kjo është edhe germa që u saktësua,

e) emëron dhe jep grada për personelin e Gardës së Republikës me gradën “Drejtues i lartë” me propozim të drejtorit të Përgjithshëm;

ë) propozon strukturën dhe organikën të Gardës.

Pika 2: “Ministri ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij”.

Ky ishte neni 15.

Zoti Hodaj, nëse keni ndonjë ndërhyrje nga ana juaj, më thoni.

Neni 16 “Drejtori i Përgjithshëm”.

Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës është autoriteti më i lartë ekzekutiv, organizativ, administrativ dhe operacional, i cili përgjigjet drejtpërdrejt para ministrit për përmbushjen e misionit të Gardës.

Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës ka këto kompetenca:

- a) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Gardës;
- b) menaxhon burimet njerëzore dhe asetet financiare të Gardës;
- c) nxjerr akte administrative në lidhje me veprimtarinë e Gardës bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore;
- ç) i propozon ministrit strukturën dhe organikën e Gardës;
- d) përfaqëson Gardën në marrëdhënie me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit;
- dh) nënshkruan marrëveshje teknike dhe operationale, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Germa që u shtua këtu është germa “e”:

e) emëron dhe jep grada për personelin e Gardës së Republikës me përjashtim të gradës “Drejtues i lartë”;

Pra, grada “Drejtues i lartë” është një gradë që e jep ministri.

ë) ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në ligj dhe në akte nënligjore.

Ndërkohë, kalojmë te neni 19. Sipas asaj që diskutuam në mbledhjen e djeshme ky nen bën fjalë për zëvendës drejtorin e Përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive.

Ky nen propozohet të ketë këtë përmbajtje:

Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës gjatë ushtrimit të kompetencave të tij mbështetet nga zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm”, pra nuk kemi përcaktuar numër.

Zëvendësdrejtori kryen detyrat që i caktohen nga drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës.

Zëvendësdrejtori emërohet nga ministri, nga punonjësit e Gardës që mbajnë gradën “drejtues i parë dhe/ose drejtues i lartë”, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gardës.

Në momentin e emërimit zëvendësdrejtori merr, ruan gradën “drejtues i lartë”.

Ministri cakton një zëvendësdrejtor që të ushtrijë kompetencat dhe detyrat e drejtorit në rastet kur:

a) drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës nuk është emëruar ende;

b) në rast paaftësie ose pezullimi nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës.

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës nuk mund të ushtrijë kompetencat e drejtorit për një periudhë të pandërprerë më shumë se 6 muaj.

Drejtorët e Drejtorive në Gardën e Republikës mbajnë gradën “drejtues i lartë”.

A ka vërejtje, kontestime apo vërejtje për këtë nen nga ana e kolegëve? Nuk ka.

Ju ftoj ta miratojmë.

Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 19, i cili është një nen i ri, pasi na u desh të bënim një rinumërtim të neneve? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni tjetër është neni 29 i projektligjit, i cili, në fakt gjatë zbardhjes së projektit do të na rezultojë si neni 30 “Ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe rikthimi”.

Punonjësi i Gardës i ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet në rastet si më poshtë, janë raste të njëjta që ne i diskutuam ditën e djeshme dhe për të cilat ishim dakord:

Një punonjës i liruar, sipas shkronja “c”, “gj”, “dh” të pikës 2 të këtij neni, pra bëhet fjalë vetëm për rastet e lirimit dhe për disa pika jo për të gjitha rastet, i lind e drejta të konkurrojnë për t’u rikthyer në strukturat e Gardës kur krijohen vende të lira.

Rregullat dhe procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe rikthimi përcaktohen në rregulloren e Gardës.

A ka ndonjë vërejtje relatorja? Jo.

A kanë ndonjë gjë përfaqësuesit e ministrisë? Jo.

Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 30 të projektligjit? Kundër? Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kemi nenin 30 të projektligjit, i cili në variantin e zbardhjes rezulton si neni 31 “E drejta e informimit dhe ankimit”.

1. Punonjësi ka të drejtën e informimit për fillimin e çdo procedimi administrativ apo disiplinor dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës.

2. Punonjësi, për rastet që mendon se lirimi, pezullimi apo përjashtimi nga puna është bërë pa shkaqe të justifikuar, ka të drejtë të paraqesë ankesë, sipas përcaktimeve në rregulloren e Gardës dhe Kodin e Procedurave Administrative.

A keni vërejtje për këtë nen, kolegë? Nuk ka.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni tjetër që pason është neni 46, për të cilin ne diskutuam gjatë ditës së djeshme. Ky nen bën fjalë për kujdesin për gratë shtatzëna.

Diskutimi i ditës së djeshme mori shkas pikërisht nga kjo dispozitë. Qëllimi është gjithmonë që të zgjerohet kujdesi jo vetëm për kategorinë e grave shtatzëna, por edhe kategorinë e grave që janë kryefamiljare të vetme ose me fëmijë të mitur. Propozimi nga ana e deputeteve gra të Komisionit të Sigurisë për këtë nen ka këtë përmbajtje:

Punonjëset kryefamiljare të vetme, me fëmijë të mitur dhe gratë shtatzëna nuk mund të punojnë në funksione pune gjatë turneve të natës apo të papërshtatshme për shkak të statusit të tyre, përveçse në rastet kur me vullnet të lirë zgjedhin ta kryejnë.

Punonjësja e Gardës nuk mban uniformë në muajt e dukshëm të shtatzënisë.

Funksionet e punës që dëmtojnë shëndetin e tyre përcaktohen në rregulloren e Gardës. Ky është propozimi. A ka ndonjë pyetje nga kolegët? Ideja është që do të ketë një kujdes të shtuar jo vetëm ndaj grave shtatzëna, që janë punonjëse të Gardës, por edhe nga punonjëseve që janë kryefamiljare të vetme ose janë më fëmijë të mitur. Vetëm në rastet kur ato zgjedhin të kryejnë punë, që kryhen nga burrat që janë punonjës të Gardës, nuk mund ta kenë këtë opsion, por në çdo rast ruajnë të drejtën të mos punojnë në turnet e natës ose të kryejnë punë të papërshtatshme.

Zonja Gjebrea po më shkruan se ka një propozim në lidhje me pikën e dytë ku thuhet: “Punonjësja e Gardës nuk mban uniformë në muajt e dukshëm të shtatzënisë”, që duhet zëvendësuar me shprehjen “muajt e fundit të shtatzënisë”. Si mendoni?

**Artemis Malo**- Nuk ka kuptim shprehja “muajt e dukshëm të shtatzënisë”, sepse tani kjo varet edhe nga gruaja, më normale do të ishte “në muajt e fundit të shtatzënisë”, sepse periudha e dukshme mund të jetë në fillim mund të jetë në fund. Unë mendoj se duhet “në muajt e fundit” dhe madje të përcaktoheshin madje muajt.

**Ermonela Felaj** – A keni sugjerime të tjera?

Zonja Fici, si përfaqësuese grua nga Ministria e Brendshme.

Faleminderit!

**Elena Pici** - Jemi kujdesur ta parashikojmë mirë këtë nen dhe kemi bërë të njëjtën gjë edhe me rregulloren e Policisë së Shtetit. Pas diskutimeve edhe me gratë në Policinë e Shtetit, se këtu kemi bërë një rast të njëjtë kemi preferuar shprehjen “muajt e dukshëm të shtatzënisë” për faktin se në varësi të zhvillimit trupor që ka vetë nëna bashkë me bebin, muajt e dukshëm mund të jenë që në muajin e katërt dhe uniforma nuk ik bën, sepse uniformat janë standarde. Kështu që u diskutua që ose punëdhënësi, në këtë rast Grada, duhet të sigurojë një uniformë të përshtatshme për nën shtatzënë, ose ta lërë atë pa uniformë, kjo varet nga zhvillimi që do të ketë nëna shtatzënë. Prandaj, në parim për ne duhet të jenë të gjithë muajt, sepse ajo duhet të ketë një veshje sa më komode, që do të thotë se, nëse uniforma nuk i përshtatet të mos mbajë uniformë, ose të ketë një uniformë që i përshtatet, por uniforma duhet të personalizohet.

**Ermonela Felaj**- Zonja Gjebrea.

**Elona Gjebrea**- Këtë diskutim bëmë edhe ne, sepse ka ardhur koha që të mund të adaptohen uniforma, të cilat të jenë të përshtatshme për një grua shtatzënë. Nuk ka asgjë të vështirë për të bërë këtë. Besoj se kjo sjell edhe një lloj risie. Kështu që mbase mund të vëmë shprehjen “uniforma të përshtatshme gjatë muajve të shtatzënisë”. Nëse bëhet fjalë për muaj “të dukshëm” ose “të fundit”, unë jam përsëri te kjo e fundit, por është një çështje që diskutohet. Besoj se fakti që ne po e përmirësojmë këtë pjesë të nenit besoj se do të ketë një ndjeshmëri më të madhe sikurse e tha edhe sekretarja e përgjithshme, por besoj se do të ketë një fleksibilitet edhe në rregulloren e policisë. Më vjen mirë që ju e keni bërë diskutimin me gratë e policisë, mendoj se kjo është rruga e duhur për të dëgjuar më mirë konkretisht se cilat janë nevojat dhe me çfarë vështirësish janë përballur në momente të caktuara. Unë jua lë juve për të vendosur, cila është shprehja më e duhur,

por mendoj edhe një përshtatje e uniformës do të shihet e mirë. Nuk e di si e kanë vendet e tjera e kërkova në internet por nuk gjeta, mbase ju ose zëvendësministri keni informacion më shumë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Zoti Hodaj.

**Juljan Hodaj** – Unë, në fakt, nuk jam në gjendje të diskutoj për këtë që po komentoni por doja të ngrija një çështje tjetër. Por, meqë jemi këtu, ndoshta edhe për efekt rregullimi do të ishte mirë të përcaktonim muajt. Ajo pastaj do të rregullohet te rregullorja përkatëse siç është bërë edhe për policinë.

Çështja tjetër që desha të trajtoj është në lidhje me pikën kryefamiljare me fëmijë të mitur, nëse do t'i rrimë strikt përkufizimit i bie që fëmijë të mitur do të thotë nën 18 vjeç.

**Ermonela Felaj**– Po.

**Juljan Hodaj** – Pra një kryefamiljare që ka një fëmijë 16-17 vjeç do ta ketë këtë lloj privilegji, sepse janë moshë që nuk kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

**Ermonela Felaj** – Bëhet fjalë për kryefamiljare te vetme.

**Juljan Hodaj** – Pra nuk është për fëmijë të vegjël, por për të mitur.

**Ermonela Felaj**– Na duhet të përdorim këtë term. Po të doni mund ta shtojmë edhe 14-16 vjeç.

**Juljan Hodaj** – Ju e keni menduar dhe po e propozoni. Unë në parim nuk jam kundër, por desha të saktësoj, sepse fëmijë të mitur shkon nën 18-vjeç, por një 15-16 vjeçar nuk ka nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme nga ana e kryefamiljares. Prandaj nëse do të vinim një moshë të saktë besoj se nën një moshë të caktuar kryefamiljaret me këtë lloj përbërjeje jam shumë dakord. Gjithsesi nuk jam në gjendje të them moshën e saktë, ju e dini më mirë.

**Ermonela Felaj** – Zonja Malo.

**Artemis Malo** – Sa i përket çështjes së parë nëse do të ishte e mundshme të përfshihet në buxhet uniforma e përshtatshme që përmendi sekretarja e përgjithshme do të ishte zgjidhja më e mirë dhe më e duhur, por kjo kërkon diskutim edhe për pjesën financiare.

Unë prapë theksoj se mbiemri “e dukshme” nuk më duket e saktë.

Sa i takon çështjes që ngriti zoti zëvendësministër, në fakt, duke qenë edhe nënë vetë unë mendoj se fëmija deri në 18 mbase nuk do të njëjtën mbikëqyrje, por gjithsesi deri në 18 vjeç siç e parashikon edhe ligji nuk duhet të ndryshohet. Ky është mendimi im, sepse çdo brez ka nevojën e vet për mbikëqyrje dhe angazhim. Gjithsesi mbetet për t'u diskutuar edhe nga kolegët.

**Ermonela Felaj** –Kjo mbështet edhe nga parashikimi në pjesën e dytë që e gjitha është zgjedhje, mund të zgjedhë të punojë në këto funksione, ose në turnet e natës, ose mund të mos punojë për shkak të statusit të veçantë që ka, sepse janë shtatzënë, janë kryefamiljare. Kjo është mbrojtja për të cilën ne duhet të ndërhyjmë. Nuk besoj se kjo prek shumë njerëz në Gradë dhe të jetë e pamundur për t’u bërë, sepse mendoj se përbërja e punonjësve në Gardë janë më e madhe janë meshkuj. Megjithatë po i marrim një për një. Për pikën e parë, a jeni dakord që kategoritë të jenë tri, punonjëse kryefamiljare, me fëmijë të mitur, pa vënë kufi, duke nënkuptuar kufirin deri në 18-vjeç, dhe gratë shtatzëna”. Jemi dakord për këtë kategori, apo ka ndërhyrje? Biem dakord.

Për pikën e dytë pati një argument nga sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, që të ruhet shprehja “muajt e dukshëm të shtatzënisë”, jo me këmbënguljen që jo domosdoshmërisht kjo shprehje, por siç na shpjegoi, janë bërë diskutime dhe Rregullorja e Policisë, tanimë përdor të njëjtën shprehje kur u referohet punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë statusin e grave shtatzënë.

Në kushtet kur ndoshta do të ishte e pamundur për Gardën që të siguronte veshje për gratë shtatzëna, aq më tepër që gjendja e tyre nuk mund të jetë e njëjta pavarësisht muajve të shtatzënisë, personalisht do të mendoja që ky është term më i përshtatshëm “muajt e dukshëm të shtatzënisë”. Në qoftë se keni një propozim tjetër për këtë, na e thoni. Nuk jam për të bërë përcaktime “në muajt e parë apo të fundit”, sepse është tej personale gjendja, gjithsesi në qoftë se keni ndërhyrje...

Zonja Dhima.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë mendoj që termi i përdorur nga ana juaj është korrekt, sepse po i japim shumë rëndësi. Numri i punonjësve gra nuk është aq i madh. Në rregulloren e Gardës duhet të specifikohen detaje më të hollësishme për veshjen e grave gjatë muajve të shtatzënisë deri në momentin që do të lindin fëmijën e tyre.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Mendoj që duhet të ngelemi te këto diskutime, meqenëse ramë dakord për pikën e parë dhe për pikën e dytë. Ideja është që ne t’u japim mundësinë grave që të ndihen sa më komode me punën dhe të kenë liri në veshjen e tyre gjatë kohës së shtatzënisë.

Mendoj që neni 46, me titullin e propozuar...

**Myslim Murrizi** – Unë do të isha dakord që të mos vinin fare në punë dhe të merrnin rrogën e plotë gjatë kohës së shtatzënisë, se Shqipëria po plakët.

**Ermonela Felaj** – Kanë leje edhe ato, edhe baballarët.



**Myslim Murrizi** – Lëri baballarët, se ata nuk lindin, por zonjat qysh në muajin e tretë të marrin rrogën e plotë me gjithë shpërblim.

**Ermonela Felaj** – Mirë.

Neni 46 “Punonjëset familjare të vetme, me fëmijë të mitur dhe shtatzënë nuk mund të punojnë në funksione pune gjatë turneve të natës apo të papërshtatshme për shkak të statusit të tyre, por me vullnet të lirë zgjedhin ta kryejnë.

Punonjësja e Gardës nuk mban uniformë në muajt e dukshëm të shtatzënisë.

Funksionet e punës që dëmtojnë shëndetin, të përcaktuara në këtë nen, përcaktohen në rregulloren e Gardës”.

Kush është dakord me nenin 46? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 56 “Shkeljet dhe masat disiplinore”. Edhe ky nen është rishkruar. “Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit, që bie në kundërshtim me këtë ligj dhe rregulloren e Gardës.

Shkeljet disiplinore kategorizohen të lehta dhe të rënda.

Punonjësi që kryen shkelje disiplinore ndëshkohet:

Për shkelje të lehta disiplinore me masat;

Vërejtje;

Vërejtje me paralajmërim;

Për shkelje të rënda disiplinore me masat:

Mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë mujore;

Shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet;

Përfshirje nga Garda e Republikës.

4. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve. Nuk po i lexoj, sepse nuk kishin ndonjë problem me afatet.

5. Efektet e masës disiplinore për punonjësën fillojnë pas përfundimit të procesit disiplinor, ku përfshihet edhe procedura përkatëse e ankimit.

6. Punonjësi administrativ, për shkeljet e kryera, ndëshkohet me masë disiplinore të përcaktuar në kontratën e punës.

7. Procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Gardës”.

Ky është neni 56 i ligjit, të cilin ne e titulluam “Shkeljet dhe masat disiplinore”. Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 57 “Ankimi ndaj shkeljeve disiplinore”.

“Punonjësi, ndaj të cilit merret masë për shkelje të lehtë disiplinore, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit që i ka dhënë masën brenda 5 ditëve nga çasti nga çasti i marrjes dijani me shkrim për dhënien e masës disiplinore.

Punonjësi, ndaj të cilit merret masë për shkelje të rëndë disiplinore, ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Apelit, brenda 10 ditëve nga çasti i marrjes dijani me shkrim për dhënien e masës disiplinore.

Gjatë procesit të ankimit punonjësit duhet t'i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur në përputhje me parimet e Kodit të Procedurës Administrative.

Punonjësi ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative. (Në fakt, duhet të themi “në Gjykatën Administrative, sepse ai mund ta ankimojë edhe në shkallën e dytë)

Procedurat për zbatimin e këtij neni, përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Apelit përcaktohen në rregulloren e Gardës”.

Ky është edhe neni i fundit. Kush është dakord me nenin 57? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit “Për Gardën e Republikës”? Kundër? Abstenim?

Miratohet ky projektligj, duke i hapur kështu mundësinë Gardës së Republikës që të funksionojë mbi bazën e një ligji të ri, që besoj se është edhe bashkëkohor.

Faleminderit, kolegë, për këtë pikë të rendit të ditës!

Faleminderit kolegëve të Ministrisë së Brendshme!

Ditë të mbarë!

**Juljan Hodaj** – Faleminderit dhe ditë të mbarë!

**Ermonela Felaj** - Ndërkohë, do t'u lutesha kolegëve të Ministrisë së Drejtësisë të bëjnë akses në sistem.

*(Ndërprerje e audios)...*

**Sekretar**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve  
Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit**

**Rashela Lalaj**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Sigurinë Kombëtare*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 3.3.2021, ora 10:45

**Drejton mbledhjen:**

**Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”.

**Marrin pjesë:**

Ermonela Felaj, Elona Hoxha Gjebrea, Antoneta Dhima, Artemis Dralo Malo, Elena Xhina Duka, Xhemal Qefalia, Ylli Shehu, Myslim Murrizi, Luan Duzha, Arben Elezi, Edmond Rrushi dhe Nimet Musaj.

**Mungojnë:**

Paulin Sterkaj, Alban Zeneli, Anduel Xhindi, Sadi Vorpsi, Luan Harusha, Lefter Maliqi dhe Edmond Stojku.

**Të ftuar:**

Klajdi Karameta – Zëvendësministër i Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

**Ermonela Felaj** – Përshëndetje edhe një herë!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Kemi në linjë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, zëvendësministrin, zotin Karameta, dhe drejtorin, zotin Besmir Beja.

Faleminderit!

Mirë se keni ardhur!

Ndërkohë, relatorja besoj se është gati, gjithashtu, edhe kolegët me tabelën e projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”. Në krahun e majtë të tabelës keni ligjin aktual “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve”, që besoj se do t’ju ndihmojë për të bërë krahasimet dhe për të kuptuar se çfarë propozimesh të reja ka dhe çfarë ka ndryshuar në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtij shërbimi. Ndërkohë, në anën e djathtë të tabelës keni edhe sugjerimet e ardhura nga grupe të ndryshme interesi dhe jo vetëm. Për këtë pikë dua të sqaroj se në momentin që ne filluam diskutimin e këtij projektligji Komisioni i Ligjeve, i cili është komision përgjegjës për këtë projekt, kishte kërkuar disa opinione, vërejtje dhe sugjerime nga disa ente. Një pjesë prej tyre i kanë sjellë qëndrimet e tyre në raport me këtë projektligj. Për shembull, sugjerimet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror janë depozituar tanimë në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni i Sigurisë, po ashtu, i disponon. Ndërkohë, sugjerimet e OSBE-së, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme ende nuk janë depozituar në Kuvendin e Shqipërisë. Sidoqoftë, ne kemi një program, një kalendar të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve dhe mund të jetë miratuar edhe në seancë plenare, së cilës jemi të detyruar t’i përmbahemi, kështu që sot do të vazhdojmë me diskutimin nen për nen të këtij projektligji, duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet e ardhura deri tani, sikundër thashë, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe nga Shërbimi Informativ i Shtetëror.

Kështu, besoj se relatorja, e cila është njohur më në hollësi me projektin dhe me sugjerimet e ardhura, do të na ndihmojë që ta trajtojmë në kohën e duhur këtë projekt deri në fund. Ne jemi komision për dhënie mendimi, kështu që çdo sugjerim nga kolegët natyrisht që do të diskutohet edhe në komisionin përgjegjës, në Komisionin e Ligjeve.

Atëherë, fillojmë me nenin 1 të ligjit, që ka të bëjë me objektin. “Ky ligj ka për objekt përcaktimin e misionit, të mënyrës së organizimit e të funksionimit të Shërbimit për Kontrollin e Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, statusin, karrierën, si dhe të drejtat, detyrat e përgjegjësitë e punonjësve të këtij shërbimi.”

A ka vërejtje apo sugjerime për këtë nen?

**Elena Xhina** – Jo, për këtë nen nuk kanë ardhur sugjerime as nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe as nga SHISH-i. Gjithashtu, edhe unë si relatore nuk kam vërejtje.

**Ermonela Felaj** – Dakord!

Atëherë, kolegë kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kalojmë te neni 2 “Fusha e veprimtarisë”: “Shërbimi për Kontrollin e Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale e ushtron veprimtarinë e tij ndaj strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe ndaj institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”. Për këtë nen nuk ka vërejtje dhe sugjerime.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3 “Përkufizime”. Natyrisht, këtu gjejmë të përkufizuar termat kryesorë që janë në përmbajtje të ligjit.

Po, zonja relatore.

**Elena Xhina** – Edhe këtu nuk kemi vërejtje.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Po, zoti Murrizi.

**Myslim Murrizi** – Faleminderit, kryetare!

Ju kërkohet ndjesë, sepse nuk kam qenë në hapjen e shqyrtimit në parim të këtij projektligji dhe do të doja të dija nga dikush prej Ministrisë së Drejtësisë, nëse Shërbimi i Çështjeve të Brendshme të Burgjeve i Ministrisë së Brendshme e ka marrë për analogji ligjin, apo ka ndonjë diferencë? Pse pikërisht lind nevoja e këtyre ndryshimeve në këtë kohë? Nuk e di kush mund të përgjigjet, duke ju kërkuar ndjesë, pasi jam me vonesë në kohë, por e bëra këtë pyetje, meqenëse nuk kam qenë në mbledhjen e parë, kur keni bërë shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Murrizi!

Po, zoti Karameta.

**Klajdi Karameta** – Faleminderit, zonja kryetare!

Në radhë të parë, u uroj të gjithë anëtarëve të komisionit që të jenë mirë.

Për sa i përket pyetjes, mund të them se të gjitha ndryshimet që kemi ndërmarrë në këtë projektligj kanë pasur si synim një reformë strukturore, pak a shumë, të shërbimit, duke kaluar në

varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe duke i siguruar një zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë. Duke qenë se struktura e tij për momentin është pak e shpërndarë, në disa institucione është bërë kjo reformë, e cila synon pikërisht një lloj përqendrimi të shërbimit si një agjenci e Ministrisë së Drejtësisë, duke pasur parasysh edhe faktin që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është një ndërmarrje relativisht e madhe për sistemin tonë me rreth 3500 punonjës në sektorin civil dhe në sektorin policor. Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe faktin që administron rreth 5 mijë të burgosur, pra është një mekanizëm ku në total administron 8 mijë persona. Detyra kryesore e shërbimit është pikërisht që të garantojë një *check and balance*, pra të krijojë një mundësi që Policia e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës në njëfarë mënyre të kenë një levë kontrolli, pra të kontrollohen në mënyrë objektive, gjithmonë në kuadër të ligjit, në mënyrë që puna e mirë, që është bërë prej tyre deri më sot nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, të bëhet edhe më mirë. Ky ka qenë, pak a shumë, *background-i*, dëshira dhe synimi për të bërë këtë përmirësim ligjor, të cilin e kemi përpara.

Faleminderit!

**Myslim Murrizi** – Sa ka qenë numri i punonjësve dhe sa pritet të shkojë me ndryshimin e ligjit? Pra, sa është sot numri i punonjësve të Shërbimit të Brendshëm të Burgjeve dhe sa parashikohet të shkojë me ligjin e ri?

**Ermonela Felaj** – Po, zoti Karameta.

**Klajdi Karameta** – Për sa i përket numrit, unë nuk di të them, pasi numrin ekzakt nuk e di, por kam përshtypjen se është i përfshirë në materialet që janë shpërndarë, nëse jam i saktë.

**Myslim Murrizi** – Nuk e kemi.

**Klajdi Karameta** – Kam përshtypjen se në material ka qenë nr. 23. Nuk jam i sigurt, por është te materialet, që janë dërguar.

A mund të më ndihmosh, nëse e ke të qartë numrin?

**Ermonela Felaj** – Më falni, sepse po na ktheni në diskutimin e para dy javëve.

Në relacion thuhet: Drejtoria e Shërbimit të Brendshëm dhe Ankesave në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale aktualisht është e organizuar në 4 sektorë dhe me një numër punonjësish prej 23 vetash. Pra, për të gjitha IEVP-të Shërbimi ka të atashuar nga 1 inspektor të tij dhe numri total i tyre aktualisht është 36 punonjës. Këta janë të përfshirë në strukturat e IEVP-ve. Referuar organikës së propozuar rishtazi, është kryer përllogaritja e personelit.

Gjithashtu, është propozuar edhe transferimi i zërit të buxhetit të pagave të 36 inspektorëve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në fondin e pagave të shërbimit.

Vlerësojmë se për efekt të ligjit, kjo procedurë nuk shkakton shpenzime financiare, por vetëm transferim të fondeve të planifikuara nga IEVP-ja te SHPP-ja. Ky është sqarimi. Më pas, ka një tabelë më të hollësishme për nivelin e pagave dhe për të gjitha të tjerat.

**Myslim Murrizi** – Zonja kryetare, me sa kuptova unë, po kaq do të jetë numri?

**Ermonela Felaj** – Nga ajo që na paraqitet këtu, sepse kjo nuk ka qenë pjesë e interesit tonë si Komision Sigurie, nuk ka efekte financiare shtesë, por është e gjitha e përballueshme me fondet aktuale të buxhetit të shtetit.

Ndërkohë, risia që sjell projektligji është se shërbimi reformohet në formë dhe në përmbajtje, veçanërisht në mënyrën se si e kryen detyrën e tij dhe ndaj cilave subjekteve e kryen këtë detyrë.

Për ta kuptuar më drejtë, do t'ju ftoja të lexoni një informacion që ne ia kemi kërkuar Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Burgjeve për rezultatet e punës së tyre për periudhën 2014-2017 dhe 2017-2020. Nëse do ta lexoni me vëmendje analizën, që ata na kanë vënë në dispozicion tanimë, konstatohet qartësisht se ka një ndryshim të dukshëm të punës nga viti 2018 e këtej, sepse më parë, po të marrim vetëm një element të thjeshtë, nuk ka pasur rekorde të këtij shërbimi të materializuara, të strukturuar, të ndara në mënyrë korrekte, ...*(Nuk dëgjohet)*... në këtë shërbim. Nga viti 2018 e në vijim, shërbimi ka qenë i orientuar për të punuar dhe për të pasqyruar rregullisht çdo veprim të vetin për sa i takon raportit që *(Nuk dëgjohet)* ... detyrimisht me prokurorinë, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe me Shërbimin Informativ Shtetëror, që janë edhe aktorët kryesorë, që kombinojnë punën.

Ky material ju është vënë në dispozicion dhe *(Nuk dëgjohet)*...

Pra, nuk keni vërejtje dhe sugjerime për nenin “Përkufizime”.

Kush është dakord me këtë nen?

Miratohet.

Neni 4 flet për misionin.

Misioni është pothuajse i njëjtë me atë të parashikuar deri tani, pra: “Misioni i shërbimit është garantimi i zbatimit të ligjit nga punonjësit e strukturave, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetit dhe të të drejtave themelore të njeriut nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të tyre”.



Po, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Faleminderit!

Nuk kam vërejtje për përmbajtjen, por për sa i përket renditjes së “Misionit”, mendoj se duhet të jetë pas nenit 1, referuar edhe teknikës legjislative.

Mendoj se duhet t’ia propozojmë komisionit përgjegjës, që ta shikojë në rirenditje.

**Ermonela Felaj** – Dakord.

A ka opinione të tjera nga kolegët pas nenit 1 apo pas nenit 2, që flet për fushën e veprimtarisë?

Zoti Beja.

**Besmir Beja** – Faleminderit, zonja kryetare!

Neni 5 përcakton objektin.

Neni 6, “Parimet e veprimtarisë”.

Pra, vendi ku është “Misioni” është në harmoni me nenet e mëpasshme. Si rregull, dispozita e “Përkufizimeve” është në vendin e duhur, për të qenë i sinqertë. Neni 3 vjen drejtpërdrejt pas fushës së veprimtarisë, kështu që besoj se teknikisht është në rregull vendosja e dispozitave, por si ta çmoni, nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor në ligj.

**Ermonela Felaj** – Zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Ndjesë, sepse unë gabova!

Për mendimin tim, duhet pas nenit 2.

Do të vijoja edhe me parimet dhe do të thosha se duhet të ishin pas “Misionit”. Më pas duhet të vazhdonim me “Përkufizimet”.

Megjithatë, është çështje e teknikës legjislative. Për mendimin tim, nuk ndryshon thelbin në ligj, por, thjesht, renditja ka rëndësinë e vet edhe nga ana estetike.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 4, edhe me sugjerimin e zonjës Xhina, që të shikohet mundësia e vendosjes së këtij neni pas nenit 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet bashkë me sugjerimin përkatës.

Neni 5 është “Objekti i veprimtarisë”.

Ka një vërejtje nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili shprehet: Nuk e kemi të qartë se cila është arsyeja që në objektin e veprimtarisë së shërbimit përfshihen edhe familjarët e të burgosurve dhe të të paraburgosurve”.

Mund të kemi një përgjigje për këtë?

**Klajdi Karameta** – Po.

Arsyeja është shumë praktike.

Nëse kemi parasysh kostilacionin se si vepohet në sistemin e burgjeve, të dënuarit janë vazhdimisht në kontakt me familjarët dhe shpesh krijohet një lidhje treshe, çka mund të sjellë vepra penale në një kostilacion ndërmjet një punonjësi të Policisë së Burgjeve, familjarit që viziton të burgosurin, i cili është i mbyllur në institucionin e riedukimit dhe të burgosurit vetë. Në një farë mënyre, një rast konkret mund të jetë bashkëpunimi për të futur lëndë narkotike në IEVP nga familjari i një të dënuari në bashkëpunim edhe me stafin e Policisë së Burgjeve. Një rast i tillë do të hynte tek objekti i veprimtarisë së shërbimit. Në këtë rast ata do të përpiqeshin të verifikonin sjelljen e nëpunësit të Policisë së Burgjeve, por mund të ndodhë që do të përpiqen të mbledhin informacion për të kuptuar se çfarë ndodh te ky kostilacion, sepse këto tri palë janë: i burgosuri, familjari i tij dhe nëpunësi i Policisë së Burgjeve, të cilët kryejnë aktivitetin e tyre.

Pra, këta janë tre aktorët, që lëvizin te kostilacioni ku inspektori i shërbimit ka punën e vet në terren.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Zoti Beja, keni diçka për të shtuar?

**Besmir Beja** – Jam shumë dakord me shpjegimin.

Qëllimi i shërbimit është të garantojë sigurinë e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Siguria në këto institucione mund të cenohet edhe nga familjarët, siç e shpjegoi zëvendësministri. Për këtë shkak është parë e nevojshme të shtohet fusha e subjekteve, që janë në veprimtarinë e subjektit.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Beja!

Zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, dua të bëj një vërejtje, pavarësisht se është bërë edhe nga institucioni i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, për mua kjo del jashtë fushës së veprimtarisë së këtij institucioni që ne po

shqyrtojmë, pasi nuk mund të pretendojmë që rrethi i subjekteve të zgjerohet kaq shumë, sa të shkojë deri te familjarët e të paraburgosurve apo të burgosurve, aq më tepër që ministria nuk ka parashikuar as se ku ndodh vepra penale, por thotë të shtrihet edhe te familjarët e të paraburgosurve dhe të burgosurve. Pra, edhe nëse ata kryejnë vepra penale në familjet e tyre ose në ambientet ku jetojnë duhet të jenë subjekt i këtij institucioni. Për mua është hapur shumë rrethi i subjekteve, nuk duhet të shtrihet deri te familjarët. Nëse kryhen këto vepra penale që janë të njohura, ato referohen në prokurori dhe nuk kanë ngelur pa u hetuar dhe gjykuar deri më sot se ka munguar ky parashikim dhe del jashtë fushës së veprimtarisë së këtij institucioni për mendimin tim. Për këtë dua të dëgjoj edhe kolegët e tjerë se çfarë mendimi kanë.

### **Ermonela Felaj – Faleminderit!**

Unë po i referohem analizës që na ka dhënë Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, dhe një nga pikat e kësaj analize e gjejmë të shkruar pikërisht këtë:

“Familjarët e të dënuarve, të paraburgosurve të proceduar”.

“Vëmendje e shtuar është treguar edhe nga ana jonë edhe në rastet e evidentimit të veprave penale gjatë procesit të kryerjes së kontrollit të familjarëve, gjë që tregon shtrirjen më të gjerë të veprimeve në lidhje me evidentimin e sendeve të ndaluara, si dhe parandalimin e tyre”.

Në periudhën e parë, që është gjatë viteve 2014 – 2017, ka pasur 6 familjarë të proceduar të të dënuarve dhe të paraburgosurve. Ndërsa në periudhën e dytë, që është gjatë viteve 2017 – 2020, janë proceduar penalisht 88 shtetas, pra familjarë.

“Lënda narkotike e evidentuar”.

Në periudhën e dytë 2017 – 2020, kemi një rritje të evidentimit të veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, prodhim dhe shitje e narkotikëve. Nga 10 raste në periudhën e parë, pra nga 2014 – 2017, kemi 84 raste në periudhën e dytë. Pra janë raste ku familjarët, duke përfituar nga takimet me të paraburgosurit apo të dënuarit, tentojnë t’i furnizojnë ata me lëndë narkotike.

Ka një rritje të sendeve të ndaluara. Për periudhën e parë nuk ka pasur të dhëna të specifikuar dhe kjo vjen si rezultat i faktit që Shërbimi ka qenë në gjendje pak kaotike përderisa nuk ka pasur të dhëna, por në periudhën e dytë të dhënat janë mbajtur dhe rezulton një situatë e tillë:

Janë sekuestrua 535 telefonë celularë, 13 orë telefon, 64 karta sim, 51 mjete prerëse shpuese, 84 raste të lëndës së dyshuar kanabis, heroinë dhe kokainë, 17 raste lëndë e dyshuar

alkoolike, në sasi të konsiderueshme, si: verë, xhin, raki dhe lloje bërsish, 27 raste vlera monetare, 31 raste sende të tjera, është kapur një dron, kartë memorie, karikues telefoni, televizor smart, USB e të tjera. Pra, këto janë disa nga rastet, në të cilat Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve ka qenë aktiv, në kuptimin e kapjes, parandalimit dhe referimit të tyre në instancat përkatëse. Prandaj unë gjykoj që është e përshtatshme të zgjerohet rrethi i subjekteve për sa u takon detyrave që ndjek Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, që tani ruan një emërtim të ri, por duke u kujdesur që aty ku themi: “të paraburgosurit, të burgosurit...” do të shtojmë edhe “familjarët”, të nënkuptohet që bëhet fjalë gjithmonë për veprat penale që kryhen në bashkëpunim me familjarë. Pra, të mos jepet ideja që vazhdon aktiviteti i Shërbimit me familjarët e të burgosurve jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Nuk e di se sa do ta plotësojë kjo shqetësimin e zonjës Xhina apo dhe qëndrimin që mbajten përfaqësuesit Ministrisë së Drejtësisë, nëse do të thoshim: “Objekti i veprimtarisë së shërbimit është: parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale dhe i shkeljeve të legjislacionit në fuqi, të kryera nga punonjësit e strukturave, si dhe nga të paraburgosurit, të burgosurit në bashkëpunim me familjarët e tyre”.

A jemi dakord me këtë, zoti Karameta, zoti Beja dhe zonja Xhina? Pra, që të mos japim përshtypjen e gabuar. Në fakt, qëllimi është i qartë.

**Klajdi Karameta** – Ne jemi dakord. Ideja është që brenda institucionit janë 2 lloje veprimtarish kontrolli që kryhen: njëra është veprimtaria e punonjësve të burgjeve, të cilët kontrollojnë familjarët, veprimtaria e dytë kontrolluese është ajo e inspektorëve të shërbimit, të cilët kontrollojnë punonjësit e Policisë së Burgjeve. Pra, në këtë kuadër është e gjitha dhe e gjitha është brenda institucionit, siç e tha edhe kryetarja. Unë jam dakord me propozimin. Besmir, a ke ndonjë gjë nga ana jote?

**Besmir Beja** – Jam dakord edhe unë, nuk kam asnjë vërejtje.

**Ermonela Felaj** – Relatorja, a keni diçka tjetër?

**Elena Xhina** – Jo, dakord, mjafton që të rezultojë i qartë fakti që bëhet fjalë për veprat që lidhen me të burgosurit dhe brenda ambienteve të paraburgimit dhe burgimit.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Kush është dakord me nenin 5, me propozimin e bërë në germën “a”? Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Parimet e veprimtarisë së shërbimit”. Nuk kemi vërejtje për këtë nen. Kush është dakord me nenin 6? Po, Faleminderit!

Po, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Dua të them që nuk e di përse e kanë hequr “pavarësinë” këtu te neni 6, te parimet. Ky është një parim shumë i rëndësishëm dhe nuk e kuptova përse e kanë hequr nga parimet.

**Ermonela Felaj** – Po, zoti Beja.

**Besmir Beja** – Në vlerësimin tim, nëse mund të jap një shpjegim, pavarësia është e garantuar nga përmbajtja e ligjit, por nëse realisht çmohet si e nevojshme për ta deklaruar si një nga parimet, mund të vendoset. Unë personalisht nuk e kisha vënë re që kishte atë lloj diferencimi, por që mund të vendoset. Por pavarësia e shërbimit nga strukturat të cilat heton, është e garantuar në të gjithë përmbajtjen e ligjit, duke garantuar një kontroll efektiv dhe hetim efektiv mbi strukturat që ka.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Po zoti Karameta.

**Klajdi Karameta** – Siç e thamë edhe më herët, në fillim të bisedës, e gjithë struktura e shërbimit reformohet në sensin që ajo del tani si një levë e Ministrisë së Drejtësisë, në ushtrim të funksionit të saj, përkundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Policisë së Burgjeve.

Siç e tha edhe kolegu, është në të gjithë frymën e ligjit, që është një institucion i pavarur me zërin e vet edhe buxhetor, brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë, edhe me kalimin e të gjithë strukturës, pra nga një strukturë që ato ishin të inkorporuar brenda institucionit të DPB-së, tani kalojnë edhe inspektorët që janë jashtë të drejtorisë qendrore, që ushtrojnë detyrën e tyre pranë institucioneve, në këtë mënyrë ato janë pjesë e institucionit. Pra, ka një ndarje shumë të qartë, qoftë nga ana buxhetore, sepse dalin si zë më vete në buxhetin e ministrisë, por edhe nga ana tjetër, që nuk paguan më nga institucioni DPB-së. Pra, është e gjithë fryma e ligjit të tillë që ata janë të pavarur nga institucioni i DPB-së, si agjenci më vete, e cila është në varësinë e plotë të ministrisë për të realizuar synimin që ministria të ketë një mundësi më shumë për kontrollin e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Karameta!

Po mendoj që mundemi ta marrim parasysh sugjerimin e koleges Xhina. Është një parim i shprehur edhe në ligjin aktual. Natyrisht, të gjitha parimet shprehen në frymën dhe në përmbajtjen e ligjit, kështu që për korrektesë besoj që duhet ta rihuazojmë germën “b” të nenit 6 të ligjit aktual në nenin 6 të projektligjit.

Kush është dakord me këtë sugjerim të relatores për nenin 6? Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i dytë, organizimi dhe struktura e shërbimit.

Neni 7. Statusi dhe shërbimi.

Shërbimi është person juridik publik buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës që mbulon çështjet e drejtësisë. Për këtë nen nuk ka vërejtje dhe sugjerime.

Po, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Edhe unë nuk kam vërejtje, por vëmë re që këtu, përveç statusit, vijon të flitet për simbolet, vulën, stemën, ndaj do t’i sugjeroja komisionit përgjegjës që të kishte një ndarje të dispozitës. Pra, flitet për statusin dhe vijon pastaj me simbolet e institucioneve. Mendoj që duhet të jetë dispozitë më vete, se nuk është se lidhen shumë më njëri-tjetrin.

**Ermonela Felaj** – Ndonjë qëndrim nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë për këtë sugjerim?

**Besmir Beja** – Teknikisht është dispozitë që ... *(nuk dëgjohet)* në kuptimin që në rastin kur caktohet statusi i institucionit, caktohen edhe çështjet praktike që e shoqërojnë atë status si person juridik publik, që është vula dhe stema. Prandaj janë vendosur në të njëjtin nen. Pra, prandaj vjen rrjedhojë logjike e statusit si një person juridik publik buxhetor dhe më pas i shoqëruar me vulën, stemën dhe mënyrën se si funksionon kjo çështje.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Në fakt edhe unë do të isha dakord me shpjegimin e zotit Beja. Besoj se të gjitha elementet që identifikojnë institucionin janë pjesë e statusit të institucionit.

Kush është dakord me nenin 7, siç është propozuar? Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 bën fjalë për buxhetin. Natyrisht, qëllim do të ketë buxhetin e tij, që do të jetë pjesë e zërave të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë. Vërejtje dhe sugjerime për këtë nuk kanë depozituar.

Kush është dakord me nenin 8? Faleminderit!

Miratohet neni 8.

Neni 9 bën fjalë për organizimin. Shërbimi vepron si strukturë e centralizuar dhe organizohet në nivel qendror. Struktura dhe organika e shërbimit miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimit të legjisllacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Ka një sugjerim nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, që personalisht unë do ta quaja me vend, por do të doja edhe qëndrimin e relatores. Sugjerimi është që struktura dhe organika e shërbimit të mos miratohet nga Kryeministri, por nga Këshilli i Ministrave. Zonja Relatore dhe pastaj përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

**Elena Xhina** – Edhe unë jam e mendimit të shprehur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, sepse miratimi nga Këshilli i Ministrave do ta bënte një vendimmarrje me bazë më të gjerë, por edhe ndoshta më të gjithëpranuar nga të gjitha palët. Kështu që, do të isha dakord që të mos e centralizonim kaq shumë që ta linim në dorë të Kryeministrit. Megjithatë të dëgjojmë edhe kolegët e tjerë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Përpara se t’ua jap fjalën kolegëve të Ministrisë së Drejtësisë, do t’u kujtoja që neni i ligjit aktual për shërbimin parashikon që struktura dhe organika e drejtorisë së përgjithshme dhe struktura vendore miratohen nga ministri me propozim të drejtorit të shërbimit, që mund të ishte edhe ky një propozim alternativ. Pra, të ruajmë atë çfarë përmban ligji aktual, t’ia lëmë Kryeministrit që më duket se e çojmë shumë larg dhe e ngarkojmë Kryeministrin me disa përgjegjësi administrative të tepërta dhe nga ana tjetër t’ia lëmë Këshillit të Ministrave miratimin e strukturës dhe organikës, ndërkohë që ministri i Drejtësisë është më afër këtij pozicioni edhe për shkakun që pozicioni është në varësi të këtij ministri.

Po, zoti Beja.

**Besmir Beja** – Faleminderit, zonja kryetare!

Parashikimi në fakt është në harmoni me ligjin nr. 90/2012 “Për administratën publike”, i cili parashikon që në çdolloj rasti të funksioneve publike, qoftë qendrore, qoftë institucionet e varësisë, struktura dhe organika miratohet me urdhër të Kryeministrit. Pra, vjen propozimi nga DAP-i dhe më pas Kryeministri miraton strukturën dhe organikën e këtij institucioni. Kështu që, në këtë rast do të propozoja që për të pasur dispozita të harmonizuara me dy ligjet të ruhet parashikimi siç është sjellë propozimi.

**Ermonela Felaj** – Dakord. Nëse ju përmendni ligjin “Për administratën publike”, ai është ligj i cilësuar. Apo jo?

**Besmir Beja** – Jo, nuk është. Ai rregullon organizimin dhe funksionimin, nuk rregullon statusin e nëpunësit civil.

**Ermonela Felaj** – Dakord. Thjesht desha të sigurohesha.

Kemi ndërhyrje të tjera?

Kolegë, besoj që ky nen do të miratohet me sugjerimin për të parë pikën 2, nëse mund të ruhet pika 2 e nenit 11 të ligjit aktual, apo do të pranohet varianti i propozuar nga Ministria e Drejtësisë. Besoj se kjo është një çështje që në çdo rast do të duhet ta vendosë Komisioni i Ligjeve, nuk është çështje e përgjegjësisë së këtij komisioni.

Kalojmë te neni 10, që bën fjalë për ministrin, që natyrisht do të jetë ai i Drejtësisë, dhe kompetencat që ka në raport me shërbimin. Ka vetëm një sugjerim nga ana e Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Mendojnë të përcaktohet ministri i dikasterit përkatës. Në fakt, ne ministrin e kemi të përkufizuar dhe e gjejmë te përkufizimet, që është ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë. Mendoj që është e nënkuptuar dhe nuk ka nevojë për shpjegime të tjera. Kush është dakord me nenin 10? Faleminderit! Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet neni 10.

Kalojmë te neni 11, drejtori i shërbimit. Drejtori i shërbimit emërohet, lirohet dhe largohet nga detyra nga ministri, sipas parashikimeve të këtij ligji. Më poshtë gjeni përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit. Zonja relatore? Kolegët?

Kush është dakord me nenin 11? Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i tretë, veprimtaria e shërbimit. Bëhet fjalë për veprimtarinë informative të shërbimit që është edhe thelbi. Ka një sugjerim nga ana e Komitetit Shqiptar të Helsinkit lidhur me këtë nen. Jemi të mendimit që ... *(nuk dëgjohet)* rregullave të hollësishme për veprimtarinë informative të mos përfshihet prokurori i Përgjithshëm dhe prokurori i Posaçëm. Institucioni i prokurorit të Përgjithshëm dhe ai i prokurorit të Posaçëm janë organe kushtetuese dhe kompetencat e tyre janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligjet përkatëse. Veprimtaria informative nuk përfshihet në kompetencat e tyre. Mund të kem një qëndrim nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe pastaj nga relatorja?



**Besmir Beja** - Në fakt Komiteti ka një lloj të drejte në komentin që ka sjellë. Sidoqoftë, versioni fillestar i ligjit ka qenë pa i përfshirë prokurorinë e Përgjithshme dhe atë të Posaçme, por, nëse nuk gaboj, gjatë procesit të konsultimit të projektligjit me prokurorinë e Përgjithshme është kërkuar që të ruhej, se duhet të jetë i ngjashëm me parashikimin e mëparshëm të ligjit, ky lloj parashikimi siç ishte më parë. Pra, të kishte një rol prokurori i Përgjithshëm në caktimin e këtyre rregullave.

**Ermonela Felaj** – Dakord. Besoj që ideja ose qëllimi pse është shkruar dhe propozuar në këtë mënyrë është fakti që, meqenëse veprimtaria informative në vetvete është e lidhur me përgjimet, përgjimet janë drejtpërsëdrejti të rregulluara nga këto tri figura kryesore, ministri, që mund të jetë ai i Drejtësisë apo i Brendshmi, në çdo rast flasim për përgjimet që bën SHÇBA-ja, prokurori i Përgjithshëm dhe prokurori i SPAK-ut.

Sidoqoftë, kolegë, unë ju ftoj që Komisioni i Ligjeve për këtë nen të vendoset sipas opinionit që do të japin Prokuroria e Përgjithshme dhe SPAK-u, meqenëse u është drejtuar tanimë Komisioni i Ligjeve për mendim këtyre institucioneve dhe do të ishte më e udhës që të merrej parasysh mendimi i tyre. Kështu që do të propozoja të kalonim në nenin tjetër. Dakord?

Neni 13 “Mbledhja, administrimi dhe marrja e të dhënave”, për të cilin ka sugjerime edhe nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, edhe nga SHISH-i.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit thotë: “Në cilin ligj apo dispozitë mbështetet mbledhja e të dhënave në fshehtësi dhe për çfarë qëllimi? Kjo praktikë ka të bëjë me respektimin e lirive dhe të drejtave të shtetasve, prandaj duhet të jetë e motivuar. Është, në fakt, kufizim i lirisë dhe i të drejtës për privatësi. Nëse mbledhja e të dhënave nëpërmjet kërkimit të provës kryhet në përputhje me legjislacionin procedural penal, nënkuptohet se duhet të ketë filluar çështja penale”.

Ndërkohë, nga ana e Shërbimit Informativ Shtetëror sugjerohet: “Në nenin 13 të projektligjit tek titulli “Mbledhja, administrimi dhe marrja e të dhënave” vihet re se nuk përcaktohet asnjë rregull lidhur me administrimin e të dhënave, ndërkohë që mbledhja dhe marrja nuk janë diferencuar si koncepte të ndryshme në kuptim të këtij projektligji. Gjithashtu, pika 4 e këtij neni është përsëritje me pikën 1 të nenit 12 “Fusha e veprimtarisë informative””.

Nuk e di nëse jeni gati për të dhënë një opinion në lidhje me këto vërejtje të bëra nga këto dy institucione.

Kush dëshiron ta marrë fjalën?

**Klajdi Karameta** – Të flasë zonja Xhina, po.

**Ermonela Felaj** – Po, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Unë i kam lexuar vërejtjet që janë bërë, por, në fakt, nuk gjej ndonjë problematikë te dispozita, sepse, nëse do të shohim pikën 4 të nenit, rregullat dhe procedurat për të gjitha këto aktivitete janë përcaktuar dhe përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit, Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtorit të Prokurorisë së Posaçme. Pikërisht, po të rikthehemi te diskutimi që bëmë te neni i mëparshëm, prandaj na duhen këto elemente garancie, që është Prokurori i Përgjithshëm apo drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, për të pasur kujdes në hartimin e këtyre rregullave.

Kështu që unë nuk shoh realisht ndonjë problematikë. E kam parë me kujdes dhe nuk shoh të ketë ndonjë cenim, sepse kjo është veprimtaria informative apo rrethi i veprimeve që kryen ky institucion; këto që janë parashikuar.

**Ermonela Felaj** – Okej, faleminderit!

Pra, me sa shoh, kontestimi në njëfarë mënyre lidhet me pikën 4 të nenit 13, ku thuhet se rregullat dhe procedura për grumbullimin në fshehtësi të të dhënave, në përputhje me nevojat e shërbimit, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Pra, kjo është ndërhyrja që bëhet në ligj, duke mos i lënë pavarësi, po themi, të plotë, diskrecion të plotë shërbimit që në mbledhjen e të dhënave me fshehtësi të jetë krejt i lirë, përkundrazi duhet të ketë disa rregulla se si ai mund të mbledhë të dhëna në fshehtësi. E gjitha i referohet përgjimit, në çdo rast sepse ky është mjete për kërkimin e provës dhe që, sigurisht, kryhet në mënyrë të fshehtë, jo të hapur.

Nuk e di a kemi një qëndrim nga ju?

Po, zoti Karameta.

**Klajdi Karameta** – Në radhë të parë, pa dyshim që të gjitha procedurat do të kryhen në zbatim të udhëzimeve të përbashkëta që do të dalin. Duhet të kemi parasysh edhe diçka, se kur flasim për veprimtari shërbimesh informative, është më se normale që ata do të veprojnë në fshehtësi, sepse informacioni nuk mund të mblidhet ndryshe.

Për sa i përket pjesës së fundit të komentit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, nëse mbledhja e të dhënave nëpërmjet kërkimit të provës kryhet në përputhje me legjislacionin procedural penal, nënkuptohet që duhet të ketë filluar çështja penale, kryesisht kjo që po flasim ne nuk ka lidhje me këtë, por lidhet kryesisht me parandalimin. Domethënë, parandalimi nënkupton që nuk kemi çështje penale, por po kryhet pikërisht një aktivitet gjurmues hetues në fshehtësi për të bërë të

mundur parandalimin që të mos ndodhë vepra penale. Normalisht, ky lloj gjurmim hetimi duhet të kryhet në përputhje me udhëzimin, që e përmendi edhe kolegja pak më parë, që do të jetë një produkt pune i përbashkët ndërmjet prokurorisë dhe ministrisë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Zoti Beja, keni diçka, apo jeni dakord me qëndrimet e shprehura?

**Besmir Beja** – Dakord me të gjitha shpjegimet. Pra, duhet vënë theksi që veprimtaria në këtë lloj rasti, siç e përmendi zëvendësministri, është parandaluese që do të thotë se një nga llojet e veprimtarisë që do të duhet, për shembull, të jetë edhe përgjimi ambiental veç llojeve të tjera të përgjimeve. Përgjimi ambiental mund të kryhet edhe në pjesën e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Në këtë kuptim, do të duhet rregulluar procedura se si do të kryhet ky lloj përgjimi, bashkërisht me Prokurorin e Përgjithshëm dhe atë të Posaçëm. Pra, se si do të parandalohet kryerja e veprave penale në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale nëpërmjet kësaj lloj veprimtarie që kryen shërbimi, pra veprimtarisë parandaluese të tij. Ky është shkaku kryesor pse duhet rregulluar kjo lloj veprimtarie dhe ky është shkaku kryesor pse shtrohen subjektet ose institucionet që e rregullojnë këtë lloj veprimtarie, duke përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë e Posaçme, se vepra penale që mund të parandalohet mund të përfshijë edhe juridiksionin e këtyre lloj prokurorive.

Kjo ka qenë logjika kur është hartuar kjo lloj dispozite.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Okej.

Atëherë, unë besoj që sqarimet për këtë nen u dhanë dhe sipas këtyre sqarimeve; kemi dakordësi për përmbajtjen e dispozitës, sipas propozimit të Këshillit të Ministrave.

Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 14. Ndjesë, te neni 15.

Kalojmë te neni 15 “Informimi për të dhëna dhe vepra penale”: “Drejtuesit dhe punonjësit e strukturave, të cilët, gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale të kryer nga punonjësit e strukturave ose përfshirjen në çdo lloj

veprimtarie kriminale të tyre, njoftojnë shërbimin, pavarësisht nga hierarkia administrative e tyre dhe detyrimet që burojnë nga akte të tjera ligjore”.

Besoj se neni është i qartë, është detyrim i përgjithshëm që e kanë të gjithë shtetasit pa përjashtim dhe pavarësisht detyrës që kryejnë për të kallëzuar veprën penale.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 16 “Përpunimi i të dhënave personale”. Neni, për sa duket nga përmbajtja, është deklarativ, sepse i adresohet vazhdimisht ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Kështu që do t’ju ftoja ta votonim sipas variantit të propozuar.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17 “Ruajtja, administrimi dhe përdorimi i informacionit hetimor ose të klasifikuar”. Për këtë nen nuk ka të depozituar asnjë vërejtje.

Vlerësoj faktin që Shërbimi Informativ i Shtetit, që është organi edhe më teknik në këtë drejtim, nuk ka depozituar asnjë vërejtje.

Atëherë, kush është dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 18 që bën fjalë për arkivin. Pra, shërbimi do të ketë arkivin e tij dhe, natyrisht, arkivi do të funksionojë për përpunimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumenteve që shërbimi do të krijojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 19 që bën fjalë për bashkëpunimin me individët.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka një sugjerim për pikën 4 të këtij neni: “Nuk jemi të mendimit që Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së detyrave, gjatë ushtrimit të veprimtarisë informative”. Në fakt, nuk e kuptova drejt këtë.

Pika 4 thotë: “Ministri, me udhëzim të përbashkët me Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, përcaktojnë rregullat e procedurat e bashkëpunimit të shërbimit me individë”. Komiteti Shqiptar i Helsinkit nuk është dakord që të jenë pjesëmarrës Prokurori i Përgjithshëm dhe SPAK-u në udhëzimin e përbashkët, sepse gryojnë që kjo është një

veprimtari operative që i lë jashtë prokurorin e Përgjithshëm edhe prokurorin e SPAK-ut. Ky është sugjerimi që bëhet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Nga kolegët? Nga relatorja?

**Elena Xhina** – Unë jam e mendimit që dispozita duhet të qëndrojë siç është, pasi vazhdojmë të bëjmë po atë diskutim, që shërbejnë si elemente garancie për këto dispozita, që kanë të bëjnë me çështje delikate dhe që lidhen me informimin apo me gjurmimin, në këtë rast me bashkëpunimin, por për detyra dhe ushtrimin e veprimtarisë informative. Për sa kohë që flasim për veprimtari informative, e mira është që të kemi këto elemente garancie dhe unë jam e mendimit që dispozita duhet të qëndrojë siç është.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Kemi koment tjetër nga ana e Ministrisë së Drejtësisë?

**Klajdi Karameta** - Dua të them që vetë komenti i Komitetit të Helsinkit është pak i paqartë, se thotë thjesht nuk jemi të mendimit që të jetë kështu dhe s’japin një argumentim. Në thelb vetëm thonë që kjo ka të bëjë me vetëveprimtarinë operative. Ka ndonjë gjë që flet kundër, që të rregullohet veprimtaria operative me një udhëzim të përbashkët? S’më duket argument shumë i fortë edhe si koment.

**Ermonela Felaj** – Në fakt, nuk është vetëm dhe thjesht marrëdhënie operative kjo veprimtari operative, kështu që, realisht nevojitet garancia që ju keni shprehur në ligj, nëse e duam vërtet të mbrojmë të drejtat dhe liritë e njerëzve dhe të mbrojmë privatësinë mbi të gjitha.

Atëherë, kush është dakord me nenin 19 sipas variantit të propozuar nga Ministria e Drejtësisë?

Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 20. Bashkëpunimi me institucionet shtetërore, private apo agjencitë e huaja analoge. Kujtoj që, në fakt, ky projekt është realizuar me asistencë të Ambasadës Britanike, kështu që, natyrisht ka një qasje tjetër edhe në procedurat që mund të aktivizojë Shërbimi, për të bërë të mundur parandalimin dhe goditjen veprave penale që krijohen si pasojë e ekzekutimit të vendimeve penale me subjekt punonjësit apo dhe të dënuarit të paraburgosurit dhe familjarët e tyre.

Atëherë, kush është dakord me nenin 20 të projektit?

Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në seksionin tjetër. Veprimtaria hetimore. Neni 21. Atributet e Policisë Gjyqësore. Personeli operacional i Shërbimit, në bazë të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, gëzon atributet e Policisë Gjyqësore. Punonjësi operacional kryen veprimtari procedurale përgjatë të gjitha fazave të procedimit penal, të urdhëruar apo deleguar nga organi procedues ose me iniciativën e vet, sipas rregullave të legjislacionit procedural penal në fuqi.

Keni vërejtje, sugjerime për këtë nen?

Atëherë, kush është dakord me nenin 21?

Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 22. Hetimi i shkeljeve. Në qoftë se nga hetimet paraprake vërtetohet se ekzistojnë elementet e shkeljes disiplinore apo administrative, shkelja i referohet strukturës përgjegjëse për të filluar procedimin disiplinor apo administrativ. Dhe vazhdon neni më tej në rastin, që në rastin kur ka vepër penale materialet i referohen prokurorisë.

Nuk ka vërejtje, sugjerime për këtë nen.

Kush është dakord ?

Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23. Veprimtaria analizuese. Shërbimi kryen analiza dhe bën rekomandime për drejtuesit e strukturave për çështjet e zbatimit të ligjshmërisë, si dhe parandalimin e kryerjes së shkeljeve gjatë ushtrimit të detyrës. Ministri miraton, të paktën një herë në vit, programin për kryerjen e veprimtarisë analizuese nga Shërbimi.

Në fakt, edhe gjatë kohës që u prezantua ky projekt një nga pyetjet që u ngrit në Komisionin e Sigurisë, ishte pikërisht ajo që kishte të bënte me analizën e punës së këtij Shërbimi, me të cilën, në fakt, Parlamenti nuk ka qenë ndonjëherë i njohur dot drejtpërsëdrejti, përveç se në rastin, kur duhet të pyetet ose i kërkohet me pyetje ministrit të Drejtësisë.

Ka sugjerime për këtë nen?

Kush është dakord me nenin 23?

Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 24. Mbajtja e armës dhe mjeteve të përdorimit të forcës

Pra, disa nga punonjësit e Shërbimit natyrisht do të pajisen me armë, por kuptohet që pajisja me armët e tyre do të funksionojë edhe konform ligjit të ri për armët, që ne kemi kaluan në fakt, në sesionin që sapo mbyllëm, të kësaj legjislature.

Atëherë, kush është dakord me këtë nen?

Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25. Përjashtimi nga publikimi. Të dhënat, informacionet e burimet e krijuara dhe të administruara nga Shërbimi përjashtohen nga detyrimi për t'u bërë publike, përveçse kur një gjë e tillë autorizohet paraprakisht me shkrim nga ministri.

Ka një vërejtje nga SHISH-i, përjashtimi nga publikimi, sipas të cilit të dhënat, informacionet e burimet e krijuara dhe të administruara nga Shërbimi përjashtohen nga detyrimi për t'u bërë publike, përveçse rastit kur autorizohet nga ministri, kjo gjë sipas SHISH-it duhet të parashikohet edhe rasti përjashtimor, kur informacioni apo burimet e informacionit janë të klasifikuara sekrete, sipas ligjit "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror", i ndryshuar, që në fakt ka një afat, për sekretin shtetëror kur ai deklasifikohet dhe që natyrisht vetëm ministri nuk mundet që të mos e respektojë këtë afat, që ka vendosur ligji i posaçëm. Jemi dakord që ta marrim parasysh propozimin e SHISH-it për këtë nen?

Po, zoti Beja.

**Besmir Beja** – Thjesht koment. Pra, ministri në çdo lloj rasti, kur lejon publikimin e informacionit, do kujdeset që publikimi i informacionit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo do të thotë që, në qoftë se një informacion është i klasifikuar, sigurisht që ministri nuk mund të lejojë publikimin e këtij informacioni. Këtu ne po vendosim një prag akoma më të lartë, që do të thotë, edhe informacione që nuk janë të klasifikuara nuk mund të publikohen, përveç rasteve kur lejohen nga ministri, sepse informacionet që janë të klasifikuara, me domosdo nuk do të mund të publikohen deri kur të jetë vullnetit i ministër për t'i publikuar ato, për sa kohë ka një ligj tjetër që e rregullon atë çështje në detaje.

**Ermonela Felaj** - Mendoj që mund të gjejmë një gjuhë të përbashkët, duke shtuar në fund të fjalisë së këtij neni: "Përveçse kur një gjë e tillë autorizohet paraprakisht me shkrim nga ministri

dhe në përputhje me ligjin për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” dhe kështu jemi korrekt.

Atëherë, kush është dakord me këtë nen sipas propozimit që u lexua?

Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe neni 25.

Kalojmë te neni 26. Trajtimi i ankesave dhe i informacioneve të publikut. Çdo person, përfshirë edhe punonjësit e strukturave, ka të drejtë të paraqesë një ankesë ose informacion për çdo veprim ose mosveprim të punonjësve të strukturave që, gjatë ushtrimit të detyrës ose edhe jashtë saj, mund të përbëjë shkelje të legjislacionit në fuqi dhe rregullave të detyrueshme për zbatim. Më poshtë vijon forma në të cilin paraqitet ankesa, që mund të jetë në formë të shkruar ose mund të deklarohet në formë verbale, Shërbimi është i detyruar të pranojë dhe të shqyrtojë ankesat, si dhe të fillojë me iniciativë hetimet administrative për çdo ankesë ose informacion, që bëhet e njohur botërisht nëpërmjet medias ose çdo forme tjetër publikimi. Nuk ka pasur vërejte për këtë nen.

Zonja Xhina, jeni dakord?

**Elena Xhina** – Dakord.

**Ermonela Felaj** - Kush është dakord me nenin 26?

Po, kolege faleminderit!

Kalojmë te neni 27. Shqyrtimi i ankesave dhe i informacioneve. Vijon e njëjta logjikë në fakt, edhe për këtë 8 nen nuk të depozituara as vërejte, as sugjerime. Kush është dakord me nenin 27?

Po, faleminderit!

Miratohet.

Kalojmë te neni 28 i projektit, që është edhe neni që çel kreun e katërt të projektit, klasifikimi i punonjësve dhe marrëdhënia e punës në Shërbim. Neni 28 bën fjalë për punonjësit e Shërbimit dhe kategorizimin në pagë të punës së tyre.

Nuk e di nëse ka ndonjë ndërhyrje?

Personeli i Shërbimit ndahet në tri kategori, në personel operacional, që do kryejë veprimtarinë informativo-gjurmuese dhe hetimore, nëpunës në strukturat përgjegjëse për funksionet horizontale dhe punonjës administrativë.

A ka vërejte apo sugjerime? Jo, nuk ka.



Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29 “Kriteret e emërimit të drejtorit të Shërbimit”. “Drejtor i shërbimit emërohet personi që, përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 30, të këtij ligji, duhet të përmbushë edhe disa kriteret të tjera, që lidhen me nivelin e arsimimit të tij”. Unë kam një pyetje për këtë: pse duhet që në dispozitën e parë, ku ne flasim për drejtorin e Shërbimit, t’i referohemi një neni që vjen më pas dhe nuk e bëjmë që në krye të herës? Pra, të thuhet drejtpërsëdrejti që drejtori i Shërbimit duhet të përmbushë këto kriteret për të qenë në këtë detyrë. A ka një shpjegim për këtë?

**Besmir Beja** - Po, zonja kryetare!

Për shkak se janë kriteret e posaçme, këto janë të zbatueshme vetëm për drejtorin, ndërkohë që neni 30 ka rregulluar në mënyrë të përgjithshme të gjitha kriteret që duhen. Për të mos përsëritur të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 30, si dhe për t’i shtuar kriteret e posaçme nenit 29, është zgjedhur kjo teknikë, pasi alternativa do të ishte që të merrnim *copy-paste* nenin 30, do të përcaktonim kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë drejtori dhe çdo punonjës tjetër, si dhe kriteret e posaçme që i plotëson vetëm drejtori. Kjo është logjika e saktë.

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Beja!

Zonja Xhina.

**Elena Xhina** - Në fakt, edhe unë e vura re gjatë leximit dhe e thashë edhe në fillim që te strukturimi i dispozitave kam pasur disa vërejtje, por, meqenëse e kanë menduar kështu...

**Ermonela Felaj**- Faleminderit!

Personalisht mendoj që do të ishte mirë që kriteret e nenit 30, pavarësisht se janë kriteret të përgjithshme, të vireshin te neni 29 dhe ne mund t’i integronim fare mirë, ose mund të vazhdonim me nenin 30, duke mos i përsëritur edhe një herë kriteret, por duke thënë që kriteret e mësipërme janë kriteret të përgjithshme nga germa “a”, të cilat janë edhe kriteret të përgjithshme të pranimit në Shërbim, sepse nuk ka ndonjë kriter të veçantë dhe do të ishte më opurtune. Drejtori nuk është një figurë periferike e Shërbimit, por është një figurë qendrore dhe, për më tepër, ne Shërbimin po e njësojmë, gati, me SHÇBA-në në Policinë e Shtetit, pra, po e zmadhojmë dhe po e bëjmë shumë të dukshëm e viziv për veprimtarinë. Prandaj, mendoj se nuk është momenti që kur flasim për drejtorin, të lexojmë kriteret e përgjithshme, pa kuptuar kriteret e posaçme për drejtorin. Kështu që, unë jam e mendimit që të rishkruhet neni 29 dhe nenit 30, sepse është një gjë e thjeshtë dhe ky

do të ishte sugjerimi që mendoj se duhet t'i çohet Komisionit të Ligjeve për këtë dispozitë. U them edhe këshilltarëve të komisionit, që mund ta rishkruajmë këtë dhe t'ua çojmë atyre për mendim.

**Besmir Beja** - Zonja kryetare, nëse mund t'u propozoj një zgjidhje alternative, do të ishte që neni 30 ta vendosim si nen 29, pra fillimisht të vendosim se cilat janë kriteret e pranimit në Shërbim, dhe nenin 29 ta bëjmë nen 30 dhe të themi: “Drejtori duhet të përmbushë, përveç kriterëve të nenit 29, që janë kritere të përgjithshme, edhe kriteret më poshtë”.

**Ermonela Felaj** - Dakord.

Faleminderit

Edhe kjo është një alternativë e mirë. Pra, kur mendohemi pak më gjatë gjejmë më të mirën.

Atëherë, variantin e propozuar nga zoti Beja do ta propozojmë në Komisionin e Ligjeve dhe lehtësojmë edhe këshilltarët.

Kalojmë te neni 31 “Kriteret e arsimit sipas natyrës së punës”. Natyrisht, ka disa kritere sa i takon nivelit të arsimit për të gjithë ata që do të përfshihen në strukturën e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 32 “Kriteret e posaçme”. Këtu ka një sugjerim nga SHISH-i, ku thuhet që sugjerojmë që në nenin 32, “Kriteret e posaçme të pranimit” mjafton të lehtësohet pika “ç”, e cila ka këtë përmbajtje: “Punonjësit, para se të pranohen në Shërbim në strukturat operationale, duhet të kenë përvojë pune jo më pak se 2 (dy) vjet në këto struktura. Një nga strukturat është strukturat informative të Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme ose çdo strukturë tjetër të ngjashme informative”. Për këtë pikë ndërhyr SHISH-i dhe thotë: “Të jetë trajnuar në kursin e formimit bazë 6-9-mujor në institutin e SHISH-it, pasi, për analogji, procesi i rekrutimit të punonjësve të rinj në SHISH bëhet nëpërmjet konkurrimit dhe trajnimit në kursin e formimit bazë nga 6 në 9 muaj. Kështu edhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale mund të emërojë punonjës që nuk kanë vjetërsi shërbimi dyvjeçare, por t'i sjellë për trajtimin bazë pranë strukturës së SHISH-it”. Ky është sugjerimi që vjen nga SHISH-i.

Zonja Xhina.

**Elena Xhina-** Unë, në fakt, e vlerësoj propozimin, sepse ka ardhur SHISH-i si sugjerim, por do të doja t'i qëndroja dispozitës siç ka ardhur nga ministria, pasi kriteret më të përforcuara janë akoma më mirë për ne, që të ketë një përvojë pune, sepse, siç e thamë, i kemi rritur kompetencat e këtij institucioni dhe duhet të kemi edhe punonjës sa më të kualifikuar dhe më me përvojë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj -** Faleminderit!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, a janë dakord me propozimin e SHISH-it sa i takon trajnimit?

**Besmir Beja -** Këtu mund të shprehet edhe zëvendësministri, në kuptim të përfaqësimit politik të ministrisë, por, të jem i sigurtë, më pëlqen propozimi i SHISH-it, por do ta sillja në një formë tjetër, ku ta mbajmë germën ç' dhe të vendoset një pikë dy te neni 32 dhe të themi: "Përjashtimisht mundet që nuk i ka plotësuar kriteret e pikës 1, pra nuk ka dy vjet eksperiencë pune, por, nëse i nënshtrohet trajnimit të kursit bazë, mund të emërohet si punonjës i Shërbimit". Pra, të ishte një përjashtimore lehtësuese e atyre kriterëve që janë propozuar, me qëllim që, nëse Shërbimi nuk gjen kandidatë që i plotësojnë të gjitha këto kritere, do të kishte një valvul shkarkuese që, pasi t'i trajnonte në kursin bazë të SHISH-it, të mund t'i rekrutonte si pjesë e Shërbimit.

**Ermonela Felaj-** Dakord.

Ndërkohë, unë ju ftoj të shikoni nenin më poshtë, nenin 33, i cili bën fjalë për trajnimin, dhe mendoj t'i lidhnim këto dy nene bashkë për të bërë pjesë të përmbajtjes së tyre edhe sugjerimin që vjen nga SHISH-i, që, realisht, më bën shumë sens dhe punonjësit e SHÇBA-së, një strukturë, nga e cila kemi pritshmëri të lartë nga mënyra sesi po e përjasim këtë Shërbim, ta marrin këtë trajnim nga SHISH-i, i cili është i kompletuar në këtë pjesë. Gjykoj që në opinionin e dhënë nga ata nuk ka asgjë që mund të bie ndesh me atë që ju keni propozuar, përkundrazi, është një ndihmë e shtuar dhe që rrit cilësinë e kandidatëve që pranohen në Shërbim. Pra, ne mund t'i shikonim këto dy nene, duke bërë pjesë të tyre edhe sugjerimin e Shërbimit.

Zonja Xhina, fjala për ju.

**Elena Xhina-** Faleminderit!

Në fakt, ajo që ju thatë është shumë e drejtë, sepse po ta shohim nenin 33, vetë SHISH-i është një nga ato institucionet që merr pjesë në trajnime apo formulimin e programeve të trajnimit.

Kështu që, mendoj se mund të gjejë vend ta shkrijmë te dispozita më poshtë, por unë jam e mendimit që të mos preket periudha dyvjeçare dhe të gjenim një rregullim tek trajnimi.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj**- Pra, ju mendoni që edhe dy vjet punë, edhe trajtim paraprak, përpara se të përfshihet në shërbim. Natyrisht, këtu duhet të bëjnë përjashtim ata që vijnë nga shërbimet inteligjente, sepse, derisa janë pranuar atje, atëherë e kanë bërë kursin e formimit bazë dhe nuk ka nevojë ta përsërisin.

A jeni dakord që të shikojmë një variant për shkrirjen e këtyre për të integruar propozimin e SHISH-it dhe t'ia sugjerojmë këtë gjë Komisionit të Ligjeve?

A jemi dakord? Dakord.

Kalojmë te neni 34 “Vlerësimi i punës”: “Vlerësimi i punës është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive ose i dobësive të punonjësit për kryerjen e detyrave që realizohen çdo 6 muaj. Nivelet e vlerësimit janë “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jokënaqshëm”. Këto “kënaqshëm dhe jokënaqshëm” në vende të tjera i gjejmë më shumë “mjaftueshëm” ose “jomjaftueshëm”. Atëherë, kush është dakord me propozimin?

Zonja Xhina ka një ndërhyrje.

**Elena Xhina** – Nuk do të pëlqejë të ishte në dispozitë shprehja e “aftësive” ose “dobësive”. Fjala “dobësive” për mua nuk duhet të ishte, sepse tek aftësitë evidentohen nëse ka aftësi të mira ose jo.

**Ermonela Felaj** – Atëherë, kush është dakord me propozimin për të mbajtur variantin e Ministrisë së Drejtësisë për nenin 34, duke hequr nga pika 1 fjalën “dobësi”?

Miratohet me propozimin që bëri dhe relatorja.

Kalojmë te neni 35 “Periudha e provës”: “Punonjësi, që punësohet në shërbim, i nënshtrohet një periudhë prove që zgjat 1 vit nga data e emërimit”.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit mendon se në rastet e moskonfirmimit punonjësit duhet t'i njihet e drejta e anikimit. Ky është sugjerimi që ka ardhur në lidhje me këtë nen.

Zoti Beja ose zoti Karameta.

Faleminderit!

**Klajdi Karameta** – Sipas pikëpamjes sime, pra miratimi i ministrit në vetvete përbën një akt administrativ. Akti administrativ mund të goditet në çdo gjykatë të juridiksionit përkatës,

Gjykatë Administrative e Shkallës së Parë. Pra, thjesht mund të bëhet një ankim jo tek organi superior, por te ministria që të ezaurohet faza para procesit dhe më pas është e hapur rruga e ankimit në Gjykatën Administrative. Kjo është objektivisht dhe nuk ka nevojë ta citojmë në ligj.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Realisht edhe unë mendoj se nuk ka pse të parashikohet periudha e provës, e drejta e ankimit, pasi mund ta ankimojmë drejtpërdrejt në gjykatë, se nuk e pengon asnjë.

**Ermonela Felaj** – Në fakt, edhe unë do të isha për ta ruajtur këtë përmbajtje, sepse natyra e punonjësve, që hyjnë në Shërbimin e Inteligjencës, është pak më e veçantë dhe ka arsye të forta në rastin që nuk pranohen. Kështu që nuk besoj se duhet të marrë kaq diskutim të gjerë, aq më tepër që ka një lloj konfidencialiteti për sa u takon njerëzve që kryejnë këtë lloj detyrë. Duhet të mjaftohemi me kaq.

Kush është dakord me nenin 35, sipas variantit të qeverisë?

Miratohet.

Kalojmë te neni 36 “Emërimi, transferimi dhe komandimi”.

Nuk ka pasur opinione të tjera për këtë nen, pra ka pasur dakordësi me variantin e propozuar. Sidoqoftë, në qoftë se relatorja ka diçka?

Kush është dakord me nenin 36?

Miratohet.

Neni 37 “Pezullimi nga shërbimi”.

Në fakt, për këtë nen ka disa sugjerime nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe nga SHISH-i.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit shprehet: “Pse duhet të quhet pezullim kur ai transferohet, sipas pikës 1, germa “a”? Ndjekja penale mund të fillojë, por çështja mund të pushojë”.

Germa “b”: “Pse thuhet deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë? Në cilat raste punonjësi mund të kërkojë vetë pezullimin nga shërbimi? Në pikën 4 të nenit 37 thuhet se ata qëndrojnë në këtë listë deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbim, sugjerojmë që kjo të bëhet më e qartë. A duhet të ketë ndonjë afat maksimal, si duhet të veprohet me pagesën?”

Ndërkohë që SHISH-i shprehet: “Sugjerojmë që neni 37 “Pezullimi”, pika 5, kur punonjësi përfiton gjysmën e pagës, kur është pezulluar, ose ndaj tij ka filluar ndjekja penale, ose procedimi disiplinor, të hiqet. Në rast se ai deklarohej fajtor me vendim të formës së prerë apo përjashtohet

nga shërbimi në fund të procedimit disiplinor, nuk duhet të marrë gjatë periudhës së pezullimit gjysmën e pagës, pasi pezullimi ka ndodhur për faj të punonjësit, duke i shkaktuar dëm institucionit. Vetëm në rastet se ai deklarohet i pafajshëm, përfiton pagën e plotë të periudhës së pezullimit”.

Pra, këto janë vërejtjet që kemi për këtë nen. Kështu që dua të dëgjoj edhe relatorin, edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

Zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Në fakt, edhe unë doja të merrja një sqarim nga zoti Beja për sa i përket pikës “b” që lidhet me pezullimin. Kur themi fillon ndjekja penale deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë, në momentin kur keni hartuar dispozitën për ndjekjen penale, ju keni parashikuar që përfshin edhe kundërvajtjet, edhe krimet?

**Besmir Beja** – Ashtu siç e dini, punonjësit e shërbimit duhet të kenë një nivel të lartë integriteti dhe integriteti i tyre është thelbësor në përmbushjen e misioneve që ka shërbimi. Domethënë, nëse një subjekt, nëse punonjës i shërbimit është në ndjekje penale, pavarësisht llojit të veprës penale që ka kryer, cenon drejtpërdrejt perceptimin e publikut në integritetin e shërbimit. Për këtë shkak kemi parashikuar që ai automatikisht, pra duhet të pezullohet, në qoftë se ndaj tij ka filluar ndjekja penale. Këtu pastaj, edhe në përgjigje të komentit të SHISH-it, duhet garantuar një lloj garancie që punonjësi i shërbimit gjatë periudhës, kur është në ndjekje penale, i jepet gjysma e pagës. Gjysma e pagës këtu ka vetëm qëllimin që të garantojë që punonjësi i shërbimit gjatë kësaj periudhe të ketë mjetet e mjaftueshme të jetesës dhe të mos korruptohet për të kryer veprimet bazike të jetesës. Pra, vetëm për shkak se duhet të marrë një pagë ose duhet të mbijetojë, duhet të kryejë pastaj veprime, të cilat, në thelb, dëmtojnë të gjithë shërbimin. Për këtë arsye garantojmë gjysmën e pagës gjatë periudhës. Sigurisht, në qoftë se dënohet, largohet nga shërbimi; në qoftë se deklarohet i pafajshëm, i lind e drejta për të përfituar pagën e plotë me efekt prapaveprues.

**Ermonela Felaj** – Të vendosim pak rregull që ta ndjekim të gjithë.

Marrim germën “a”: “Punonjësi i shërbimit pezullohet kur transferohet.” Komiteti Shqiptar i Helsinkit thotë: “Si mund të pezullohesh kur transferohesh?” A mund të jetë transferimi një rast pezullimi nga detyra?

**Besmir Beja** - Më falni, nëse mund ta sqaroj edhe këtë çështje, pra transferohet në një organizëm ndërkombëtar. Domethënë, nuk është më pjesë e organikës së shërbimit, por mund të

ketë shkruar të kryejë një shërbim ose mund të ketë shkuar i deleguar, i caktuar ose edhe të punojë, si eksperiencë, në një organizatë tjetër ndërkombëtare. Ky është shkaku që marrëdhënia e punësimit me shërbimin pezullohet. Nuk mund të jetë një marrëdhënie vijuese, pra nuk mund të ketë të drejtën të punojë për një organizatë ndërkombëtare, për shembull, për misionin e OSBE-së në Ukrainë dhe, njëkohësisht, të përfitojë edhe të drejta që i burojnë nga marrëdhënia e punës pranë shërbimit.

**Ermonela Felaj** – Para këtij neni ne kishim nenin për transferim. Kështu që transferimi nuk është edhe pezullim. Kishim nenin 36 “Emërimi, transferimi dhe komandimi” dhe folët se çfarë ndodh në rastet kur bëhet transferimi.

**Besmir Beja** – Ndoshta ta rregullojmë terminologjinë, por janë dy koncepte të ndryshme.

Neni 36 flet për transferimin brenda shërbimit, pra nga një institucion i ekzekutimit të vendimeve penale në një institucion tjetër të ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 37, pika “a”, i referohet transferimit për nevoja të institucionit në një organizatë ndërkombëtare, qeveri të huaj apo në një institucion ndërkombëtar për periudhën përkatëse. Pra, nënkupton që ky punonjës i shërbimit nuk është më i transferuar dhe përmbush funksionet brenda shërbimit, por është transferuar në një agjenci ose në një organizatë tjetër të huaj dhe përmbush funksionet për atë organizatë.

**Ermonela Felaj** – A e gjejmë këtë rast në ndonjë legjislacion tjetër, pra që ndodh kjo lëvizje, por punonjësi quhet i pezulluar?

**Besmir Beja** – Unë e di që ndodh shpesh. Ndoshta zgjedhja e fjalëve nuk është zgjedhja më e goditur, por realisht është praktikë shumë e përhapur.

Unë vetë nuk jam shumë i qartë se çfarë ndodh kur këta mbarojnë misionin atje, a kthehen prapë në shërbim apo jo. Në këtë kuadër kjo do të ishte e rëndësishme të sqarohet, sepse rezulton që, nëse do ta ripranosh prapë në shërbim, duhet zgjedhur ndoshta një fjalë më e goditur.

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Xhina!

**Elena Xhina** – Në fakt, unë nuk e gjej me vend që ne ta quajmë “pezullim” këtë, sepse ne e dimë se pezullimi është kur ndërpritet marrëdhënia e punës, kur për faj të punonjësit ka ndodhur një shkelje e të tjera, pra dalim nga ai koncepti i njohur i pezullimit.

Për sa kohë kemi të bëjmë me transferim dhe është jashtë institucionit, ashtu siç zoti Beja e shpjegoi, për mua mund të vendoset një pikë te transferimet, te dispozita më lart, ku ju përcaktoni

qartë se çfarë është ky lloj transferimi dhe gjatë kësaj periudhe nuk trajtohet me pagë dhe nuk i përfiton të drejtat e pozicionit që ka. Pra, nuk e gjej me vend ta kemi te “pezullimet”.

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Ndërkohë, kam një sugjerim nga ana e këshilltarit të Komisionit të Sigurisë, që në ligjin “Për nëpunësin civil” njihet si rast pezullimi transferimi në një institucion tjetër, kështu që do të duhet thjesht dhe vetëm ta verifikojmë dhe nëse është kështu, kuptohet se ne do ta mbajmë këtë gjë edhe këtu dhe nëse është ndryshe do të duhet t’ia sugjerojmë Komisionit të Ligjeve që në bashkëpunim me ju ta shprehë si duhet.

**Burrë** – Nëse më lejohet për ta konfirmuar, është pikërisht ashtu neni 54, pika “b”, e ligjit “Për nëpunësin civil”, kështu që faleminderit juve dhe këshilltares për gjetjen e rastit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Për germën “b”: “Pezullohet kur fillon ndjekja penale deri në marrjen e vendimit të formës së prerë”.

A jemi dakord me germën “b”?

**Elena Xhina** – Unë jam dakord me germën “b”, por duhet të bëjmë një saktësim, sepse është ngritur edhe pretendimi në lidhje me marrjen e një vendimi të formës së prerë.

Kur kemi një kundërvajtje, prokuroria del me vendim pushimi dhe kur kemi një krim, del me gjykata me një vendim pushimi, që është i formës së prerë.

Mos ndoshta duhet të bëjmë ndonjë qartësim këtu, se vendimi i prokurorisë nuk ka formë të prerë, por është vendimi për pushim i prokurorit, ndërsa vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

**Ermonela Felaj** – Ka një vendimmarrje të një institucioni tjetër, që në një farë mënyre vendos. Këto janë brenda afateve dhe atëherë ngelet ai vendim, ai vendim do të shërbejë si vendim i formës së prerë.

**Elena Xhina** – Ky ka qenë edhe shqetësim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit në lidhje me këtë pjesë.

**Ermonela Felaj** – Kjo është e qartë praktikisht, kështu që nuk besoj se ka nevojë ta diskutojmë kaq shumë, domethënë ta marrim rast pas rasti kur vendoset pushimi e të tjerat me radhë.

Vendoset nga gjykata si masë ndaluese. Jemi krejt dakord se e ka këtë të drejtë. Fillon procedimi disiplinor për shkelje të rënda disiplinore dhe ka arsye të besohet.



Besoj se edhe për këtë germë jemi dakord.

A jemi dakord me germën “b”, pezullimin e kërkon vetë punonjësi? Dua që ta lidh me pikën 3, ku thuhet se periudha zgjat sa zgjat shkak dhe për këtë periudhë pastaj ai paguhet me gjysmën e pagës.

A mund të jetë rast pezullimi, rasti kur e kërkon vetë punonjësi?

Mendoj se duhet të ketë një dispozitë të veçantë, kur punonjësi për arsye të ndryshme studimi, sëmundjeje etj., ndërpret marrëdhënien e punës. Të parashikohet veçmas. Marr shkas edhe nga legjislacionet e tjera që i kemi diskutuar.

Ligji “Për nëpunësin civil” të “Pezullimi me kërkesë të nëpunësit” përcakton se nëpunësi civil pezullohet me kërkesë të tij dhe përmenden afatet. Janë disa raste, pezullimi për studime, kur shkon të ushtrojë veprimtarinë në kuadër të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, për shkak të një interesi tjetër të ligjshëm, sipas kësaj të vendosur nga Këshilli i Ministrave. Kërkesa paraqitet me shkrim.

Pra, është i njohur këtu si rast pezullimi.

Dakord. Do të duhet ta kalojmë. Referenca është neni 55 dhe 56 ku bëhet fjalë për efektet e pezullimit në ligjin “Për nëpunësin Civil”.

Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënieve të shërbimit civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose, në rast se pozicioni i parë është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori.

Në rast se kjo është e pamundur, nëpunësit regjistrohen në një listë që administrohet nga njësi përgjegjëse. Ata qëndrojnë në këtë listë deri në sistemimin e tyre në pozicionin e rregullt të shërbimit civil dhe vazhdohet me parashikimet e tjera.

Kam një pyetje. Punonjësit e shërbimit nuk e kanë të gjithë statusin e shërbimit civil, që ne të zbatojmë germë për germë çfarë thotë ligji “Për Shërbimin Civil”. Ata janë me status të ndryshëm.

**Besmir Beja** – Më falni! Kjo rregullon atë kategori punonjësish që nuk gjejnë rregullim në Statusin e Shërbimit Civil, për shkak se kjo kategori punonjësish mbështeten te ligji bazë që është Kodi i Punës, ndërkohë që pjesa kryesore e rregullimeve të marrëdhënies së punës është ky ligj.

**Ermonela Felaj** – Unë po mendoja këtë gjë: a duhet të shkojmë në mënyrë kaq të hollësishme në dhe të themi në ligjin e shërbimit të provës se çfarë ndodh kur pezullohen, kur ne kemi dy ligje përpara, sipas statusit të punonjësit? Në qoftë se janë punonjës të thjeshtë, do të zbatojnë Kodin e Punës dhe në qoftë se janë nëpunës civilë, do të zbatojnë automatikisht ligjin për nëpunësin civil, që është ligj i veçantë.

Pra, mendoj që të mos shkojmë në detajime të kësaj natyre, sepse dalim përtej tagrit të këtij ligji, se ky është ligj për shërbimin, nuk është ligj edhe për të rregulluar se çfarë ndodh me punonjësin kur pezullohet.

Sipas statusit që ka do të zbatohet legjisllacioni i veçantë.

**Besmir Beja** – Kjo vjen për shkak të kategorizimit i punonjësve të shërbimit. Janë punonjësit operacionalë, ata me status të nëpunësit civil dhe punonjësit e tjerë administrativë.

Punonjësit me status të nëpunësit civil nuk rregullohen nga ky ligj. Pra, pranimi i tyre në shërbim, marrëdhëniet e tyre të punës e të tjera, rregullohen nga ligji për nëpunësin civil. Ndërsa punonjësit operacionalë, për t'i garantuar që ato vërtet ushtrojnë funksionet, nuk i lejnë dot që kenë rregullimin e marrëdhënies së tyre të punës vetëm në Kodin e Punës. Atyre u duhet krijuar një bazë më e fortë dhe më e shëndetshme e mbrojtjes së marrëdhënies së tyre të punës dhe ky ka qenë qëllimi pse ne kemi rregulluar në këtë ligj statusin e marrëdhënies së punës së këtyre punonjësve, se këtë duam të garantojmë. Pra, punonjësi operacional, sa kohë ka edhe kritere shumë të forta pranimi në këtë shërbim duhet t'i garantojë edhe një status mirëfilli të mirë që të mos lëvizet pa të drejtë nga puna e tij.

**Ermonela Felaj** – Besmir, unë do të isha që të deklaronim rastet e pezullimit nga shërbimi dhe kush e bën pezullimin nga shërbimi. Ndërsa efektet, në kuptimin e pasojave apo të pagës, të rregullohen nga ligji përkatës, nga ligji i veçantë. Nuk jam që të përsëriten këtu. Çfarë kemi marrë? Kemi një dispozitë që bën fjalë për pezullimin nga shërbimi të çdolloj punonjësi, pavarësisht se çfarë statusi mban dhe kemi një rregullim *mot a mot*, të marrë *copy paste* nga ligji “Për shërbimin civil”. Kjo nuk më bën sens. Ashtu sikurse nuk më bën sens fare që ke kryer një vepër penale, je pezulluar me vendim gjykate dhe merr gjysmën e pagës? Atëherë, kot që po e bëjmë shërbimin kështu, sepse këta të gjithë do të ndihen të motivuar për të kryer vepër penale. Pse duhet ta ofrojmë këtë garanci, kur ka garanci të tjera për t'u mbrojtur, në rastin që është dënuar në mënyrë të padrejtë ai i ka të shprehura në ligje të posaçme, pra kërkon kompensim për burgim të padrejtë.

**Besmir Beja** – Nëse mund të sjell në vëmendjen tuaj nenin 28, që kemi klasifikuar punonjësit e shërbimit, janë pikërisht pikat 2, 3 dhe 4. Në pikën 2 kemi rregulluar që personeli operacional, që përveçse gëzon atributet, themi që marrëdhëniet e punës së këtij personeli rregullohen në bazë të këtij ligji. Marrëdhënia e punës së nëpunësve në strukturat përgjegjëse për funksionet horizontale rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit Civil; marrëdhënia e punës së punonjësve administrativë rregullohet në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Siç e thashë, ne duam të garantojmë punonjësit operacionalë, që është baza kryesore, e cila mban punën e shërbimit. Shërbimit horizontale janë financa dhe shërbimet e tjera mbështetëse, prokurimet. Ndërkohë, shërbimi administrativ do të jenë: shoferi, pastrueset dhe këto lloj funksionesh të tjera. Baza kryesore e shërbimit janë këta lloj punonjësish. Këtyre punonjësve duhet domosdo që t’u garantojmë me këtë ligj të drejtat, detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e tyre e punës me shërbimet, se ndryshe nuk do të kenë mbrojtje. Nuk bëjmë dot as referimin te ligji “Për shërbimin civil”, se janë dy lloj shërbimesh të ndryshme. Rrjedhimisht, do të na duhet domosdo të vendosim parashikime në këtë ligj për të garantuar që të drejtat, detyrimet, që burojnë nga marrëdhëniet e punës. të jenë të mirëpërcaktuara. Ky ka qenë qëllimi i këtij rregullimi.

**Ermonela Felaj** – Po, ju kuptova.

Zonja Xhina, një qëndrim nga ana juaj.

**Elena Xhina** – Jam dakord me çfarë tha zoti Beja dhe me garancitë që kërkon të ofrojë, por nuk është e thënë që duhet ta marrim siç është, por ndoshta duhet t’ia përshtatim edhe rastit konkret dhe ligjit që jemi duke diskutuar.

Jam dakord me atë çfarë tha zonja Felaj që në rastet, kur personi është në ndjekje penale, punonjësi të marrë gjysmën e pagës, po, në rast se deklarohet fajtor, a e kthen gjysmën e pagës që ka marrë? Pse duhet ta futësh në këto lloj marrëdhëniesh, kthim apo dhënie parash, ndërkohë që në momentin, sepse, kur deklarohet i pafajshëm, mund të marrë pagën e munguar të atyre kohëve. Vetëm për këtë gjë kisha rezerva, për të tjerat jam dakord dhe qëndrojnë.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Unë përsëri insisto tek kjo gjë: te dispozita që po diskutojmë kuptohet qartë që rregullimi është për të gjithë punonjësit, ose u adresohet të gjithë punonjësve, se nuk ka bërë ndonjë lloj ndarjeje: “punonjësit e shërbimit” dhe nënkuptohen të gjithë punonjësit, sipas kategorive që ne diskutuam te neni 28. Te ky nen thuhet: “Marrëdhëniet e punës së strukturave përgjegjëse për

funkcionet horizontale rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil dhe për të tjerët, në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

Propozimi im: pse duhet t'i përsërisim dispozitat e ligjit këtu, tani duhet t'i verifikojmë se çfarë ka dashur të thotë ai ligj, çfarë ka pasur parasysh, por këtu mund të mjaftohemi vetëm me rastet e pezullimit dhe kush e bën pezullimin, ndërkohë që zgjidhjen e pasojave të mëtejshme t'ia lëmë legjislacionit të veçantë. Këtë po them. Ky ligj mund të ndryshojë. Pse duhet ta citosh një mënyrë të caktuar të rregullimit të pasojave, kur ligji i veçantë nesër mund ta ndryshojë komplet qasjen në këtë drejtim.

Të them të drejtën, edhe ne kemi pasur shumë debate për ligjin "Për nëpunësin civil". Dihet saga e diskutimeve të këtij ligji, edhe pasojat që i ka kushtuar buxhetit të shtetit. Prandaj kam dyshime në këtë pikë që ne duhet të marrim dhe të përsërisim të njëjtën gjë, pa qenë nevoja.

**Besmir Beja** – Nëse mund ta sqaroj, në nenin 29 dhe vijues nuk rregullohen marrëdhëniet e punës së dy kategorive të tjera, por rregullohen marrëdhëniet e punës vetëm për punonjësit operacionalë, për shkak se dy kategoritë e tjera janë të rregulluara me ligjet specifike dhe nuk është i zbatueshëm ky parashikim. Pra, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ky ligj, janë të zbatueshme në kuptim të marrëdhënieve të punës, janë të zbatueshme vetëm për punonjësit operacionalë. Ky ka qenë edhe qëllimi i parashikimit të pikës 2 të nenit 28, rrjedhimisht të pikave 3, 4 që i referohet për marrëdhëniet e tyre të punës, si për pranimin, disiplinimin e të tjera, ligjit të posaçëm, pra si nëpunësit që kanë statusin e nëpunësit civil dhe si punonjësit e tjerë që u rregullohet marrëdhënia e punës me Kodin e Punës. Nëse nuk do të parashikonim këto lloje rregullash në këtë ligj edhe për punonjësit operacionalë, marrëdhënia e punës do të rregullohej nga Kodi i Punës, që do të thotë nuk do të kishte ato garanci në kuptim të palëvizshmërisë së tyre nga vendi i punës, siç po përpiqemi t'i garantojmë nëpërmjet këtij ligji. Kushdo që të ishte, ministri apo dikush tjetër, do t'i merrte punonjësit e tij në atë lloj shërbimi, për shkak se mendojnë se ato punonjësit do t'i garantonin dhe do të ruanin në këtë lloj forme profesionalizimin që po përpiqemi të krijojmë në shërbim. Ky është qëllimi pse kemi vendosur rregullimet të posaçme në kuptim të marrëdhënies së punës për vetëm një nga ato kategoritë, e cila është baza e shërbimit që janë punonjësit operacionalë.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Zonja Xhina, ose kolegët që ndoqën këtë diskutim, a keni ndonjë opinion tjetër?

Në fakt, e kem të vështirë të biem dakord me ju. Prandaj do të më duhet që këtë sugjerim ta përcjell, në emër të Komisionit të Sigurisë, në Komisionin e Ligjeve.

Sugjerimi është që pasojat në raportet e punës në momentin që mbaron afati i pezullimit apo zhduket shkak i pezullimit, të zgjidhen sipas legjislacionit përkatës, gjithmonë në raport me statusin që ka punonjësi, pra nëse është nëpunës civil, të zbatohet ligji “Për nëpunësin civil”, nëse është punonjës operacional, të zbatohet Kodi i Punës, sepse nuk di për raste të tjera pezullimi, që nuk janë këto kategori, të marrin gjysmën e pagës. Ashtu sikurse mbroj idenë që nuk ka pse të hyjë ky ligj në këto lloj përcaktimesh kaq të hollësishme, a thua se këto po rregullohen njëherë e përgjithmonë dhe nuk do të ndërhyjë më kush. Ky do të jetë sugjerimi për këtë pjesë.

Kalojmë te sesioni III. “Përfundimi i marrëdhënieve të punës”

Neni 38.

“Marrëdhëniet e punës për punonjësit e shërbimit” “Marrëdhënia e punës përfundon nëpërmjet: lirim, largimit nga shërbimi dhe pranisë së një shkak i parashikuar nga neni 41 i këtij ligji”. Neni 41 i ligjit parashikon si shkaqe: “Rastin e vdekjes së punonjësit apo kur është deklaruar vdekja e tij, kur ai humbet shtetësinë shqiptare apo i është kufizuar zotësia për të vepruar, kur ka mbushur moshën për pension, kur konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit dhe kur dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale”. Këto janë rastet e përfundimit të marrëdhënies së punës, çfarë janë deklaruar janë deklaruar në mënyrë kumulative, edhe lirimi, edhe shkarkimi.

Kush është dakord me këtë nen?

Po, faleminderit!

Miratohet varianti i propozuar nga ministria.

Kalojmë te neni 39: “Lirimi nga shërbimi”.

Këtu ka vetëm një sugjerim nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, që ka të bëjë me shprehjen e të drejtës së ankimit në rastin kur punonjësi lirohet nga detyra.

Mendoj se në këtë rast, argumenti i Ministrisë së Drejtësisë do të ishte po ai që u përmend edhe pak më herët, gjatë një diskutimi të ngjashëm, që këto janë garanci të njohura dhe nuk ka nevojë të shprehen kudo, në çdo pjesë.

Zonja Xhina, jeni dakord ta miratojmë kështu siç është propozuar?

**Elena Xhina** – Po.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Miratohet neni 39.

Kalojmë te neni 40, që bën fjalë për dorëheqjen.

Kalova një nen, më duket? Jo, në rregull!

Neni 40: “Punonjësi i shërbimit mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbim, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim në njësinë e burimeve njerëzore të shërbimi. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj. Në rastet e justifikuara me kërkesën e motivuar të punonjësve dhe me miratimin e burimeve njerëzore, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi.”

Formulimi, thotë Komiteti Shqiptar i Helsinkit, duhet të ishte më i qartë. Është fjala për efektet 30-ditore.

Një pyetje do të kisha unë: pse është gjendur ky afati 30-ditor? Duket pak si i gjatë. Mendohet se institucioni do të pengohet në punën e tij në raste të tilla, që t’i lihet afat deri sa të bëjë një rekrutim të ri? Cila ka qenë arsyeja?

**Burrë** – Është pikërisht ajo që thatë, zonja kryetare: gjetja e një balance të drejtë mes nevojës që ka punonjësi për të përfunduar marrëdhëniet e punës, dhe nevojës që ka shërbimi për të filluar procedura të reja rekrutimi e për të pasur një afat... (*ndërprerje regjistrimi*). Në vlerësimin tonë, ky afat është tridhjetëditor.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Zonja Xhina, keni ndonjë sugjerim në lidhje me këto, apo jeni dakord?

**Elena Xhina** – Unë jam dakord!

**Ermonela Felaj** – Mirë.

Atëherë, kush është dakord me nenin 40, me sqarimin e bërë?

Po, faleminderit!

Miratohet neni 40!

Kalojmë te neni 41: “Përfundimi i marrëdhënies së punës për shkak të ligjit.”

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është shprehur si më poshtë:

“Te shkronjat ‘a’ dhe ‘d’ të pikës 1 të shtohet vendimi i gjykatës”.

Pra, marrëdhënia e punës përfundon për shkak të ligjit, kur punonjësi vdes apo kur merr formë të prerë, këtu e ka idenë, vendimi i gjykatës për deklarimin e vdekjes së tij.

Në fakt, nuk mjafton vetëm të marrë formë të prerë, sepse me sa kujtoj, ato janë vendime që botohen në Fletoren Zyrtare: shpallja i zhdukur dhe deklarimi i vdekjes. Kësisoj, ndoshta do të pritët botimi në Fletoren Zyrtare?

Me ndihmoni, meqë jeni më shumë civilistë nga ana përballë. Të njëjtën sugjerim kanë edhe për germën ‘d’: “Dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.”. Domethënë: “Dënohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.”

Janë diskutime të thjeshta këto.

Ndërkohë, SHISH-i ka thënë: sugjerojmë që konceptet e përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të plotë të pleqërisë, të përfshihet te neni 39: “Lirimi nga shërbimi”.

Gjithashtu, rastet e tjera të përfundimit të marrëdhënies së punës mund të konsiderohen thjesht mospërmbushje të kriterëve të nenit 30, “Kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbim”, duke parashikuar si pikë të veçantë në nenin “Lirimi nga shërbimi”. Përrjashtimisht, përfundimi i marrëdhënies së punës për shkak të një vendimi të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, nuk mund të konsiderohet liri, por përjashtim.

Pra, parashikon rastet e përjashtimit, si rezultat i një vendimi gjykate të formës së prerë, ose si masë disiplinore shumë e rëndë. Megjithatë, në dispozitën që ne po diskutojmë, është përdorur një term më i përgjithshëm: përfundimi i marrëdhënies së punës për shkak të ligjit. Të gjitha rrethanat e renditura aty, janë rrethana që çojnë në përfundimin e marrëdhënies së punës.

Kështu që, nëse ka ndonjë ide, nëse mund të reflektojmë diçka nga sugjerimet e bëra, në rregull, përndryshe e kalojmë në votim, sepse në fakt, dispozita më duket e drejtë ashtu siç është propozuar, dhe nuk ka nevojë të hyjmë në përcaktime të tjera, jo kur merr vendimi formë të prerë, jo kur botohet, sepse s’janë objekt i këtij ligji.

Kush është dakord me nenin 41?

Faleminderit, kolege!

Miratohet neni 41!

Kalojmë te neni 42: “Ripranimi në shërbim”.

Një punonjës i shërbimit, i liruar, sipas shkronjave ‘b’, ‘d’ dhe ‘e’ të pikës 1, neni 39 i këtij ligji mund të ripranohet në shërbim kur krijohen vende të lira në pozicionin për të cilin ai ka kualifikimin e duhur, duke iu nënshtruar procesit të konkurrimit për pranimin në shërbim.

Besoj se ky nen është në rregull!

Kush është dakord me nenin 42?

Po, faleminderit!

Miratohet!

Neni 43: “Rregullorja e shërbimit”.

“Rregullorja miratohet me urdhër të ministrit”, dhe duket korrekte.

Kush është dakord me këtë nen?

Po, faleminderit!

Miratohet edhe neni 43!

Kalojmë te neni 44: “Detyrimet e përgjithshme të punonjësit të shërbimit”.

As për këtë nen nuk kemi vërejtje e sugjerime.

Kush është dakord me këtë nen?

Po, faleminderit!

Miratohet!

Kalojmë te neni 45: “Miradministrimi i pronës shtetërore dhe i kohës së punës”.

As për këtë nen nuk kemi vërejtje.

Kush është dakord me këtë nen?

Po, faleminderit!

Miratohet edhe ky nen!

Neni 46: “Kufizimi i të drejtave politike dhe i të drejtës së grevës.”

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka bërë një sugjerim: “Derisa thuhet se nuk mund të jetë anëtar i një partie politike, nuk ka nevojë të theksohet “ose i organeve drejtuese të tyre””.

Shkronja ç: “Ai mund të kandidojë nëse më parë jep dorëheqjen.”. Shih edhe pikën 1, germa ‘ç’ të Kushtetutës. Vetëm se nuk kemi nenin, por mund ta shohim. Sidoqoftë: punonjësi i shërbimit nuk ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike brenda e jashtë orarit zyrtar, apo të shprehë publikisht bindjet dhe preferencat e tij politike.

Besoj se jemi dakord me këtë. Nuk mund të jetë anëtar i një partie politike ose i organeve të tyre drejtuese, dhe në veprimtarinë e tij nuk duhet të cenohet natyrën e depolitizuar të shërbimit.

Unë mendoj se duhet të ruhen këto, edhe shprehja “organet drejtuese”, sepse nganjëherë partitë politike i marrin si këshilltarë të jashtëm dhe ata nuk e konsiderojnë veten anëtarë partie, por janë partiakë që ç’ke me të. Kësisoj, mendoj se është mirë të jetë ky kufizim, ashtu sikundër jam dakord edhe me gjithë pjesën tjetër.



Atëherë, kush është dakord me nenin 46, siç është propozuar?

Faleminderit!

Miratohet!

Kalojmë te neni 47: “Respektimi i shërbimit dhe ndalimi i veprimtarisë jashtë misionit”

Në rregull!

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është shprehur se mundon që punonjësi i shërbimit mund të kryejë veprime të ligjshme, që nuk kanë lidhje me misionin, personale, familjare, shoqërore.

Nuk e kuptova këtë, në fakt, sepse këtu ka ndalime: punonjësit të shërbimit i ndalohet të përdorë mjetet, shenjat ose simbolet e shërbimit jashtë kryerjes së detyrës, të kryejë veprime për të realizuar qëllime dhe objektiva, të cilat nuk kanë lidhje me misionin ligjor.

Ndoshta Komiteti Shqiptar i Helsinkit është i idesë që me veshjet, me mjetet dhe simbolet mund të bëjë fotografi dhe t’i vërë në rrjetet sociale, sepse s’më vjen ndonjë shembull tjetër.

Zonja Xhina!

**Elena Xhina** – Me sa kuptoj unë, e ka për pikën ‘b’, ku thotë se punonjësi mund të kryejë veprime që kanë lidhje me jetën familjare e shoqërore. Këtu e ka idenë.

**Ermonela Felaj** – I ndalohet të kryejë veprime.

**Elena Xhina** – Po pra, pse u ndalohet thonë ata. Ata thonë se nuk duhet t’u ndalohen këto veprime.

**Ermonela Felaj** – Mirë, duhet t’i ndalohet, sepse e kemi bërë këtë diskutim edhe në herët, për punonjësit e policisë apo të strukturave të tjera të rendit e të sigurisë, që kanë një “pasion” të çmendur, veçanërisht për të ekspozuar në rrjetet sociale me armatime. Natyrisht kjo është komplet e papranueshme për etikën e punës. Kështu që jam dakord me nenin 47, siç e ka propozuar Ministria e Drejtësisë.

Kush është dakord?

Faleminderit!

Miratohet.

Kalojmë të neni 48. Raportimi i ankesave dhe shkeljeve.

Edhe për këtë nën Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka bërë një sugjerim. Ligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, është miratuar në vitin 2016 dhe për këtë janë ngarkuar KLSH me udhëzim, ILDKP-ja dhe Këshilli i Ministrave. Pra, ato institucione publike që kanë mbi 80 persona duhet të ishin ngritur që në vitin 2016 me njësitë përkatëse prej 8 personash të ngarkuar

me sinjalizimeve dhe hetimin administrativ. Ka një vërejtje që i referohet zbatimit të një ligji tjetër, por që në syrin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit ndikon edhe në përmbajtjen në këtë neni.

Atëherë mund të themi që punonjësi i shërbimit i raporton njësisë përkatëse.

**Besmir Beja** – Nëse mundem zonja kryetare, janë dy rregullime të ndryshme.

**Ermonela Felaj** – Megjithatë është thënë në pikën 2. Ndjesë!

Kush është dakord me nenin 48?

Faleminderit!

Miratohet!

Kalojmë te neni 49. Deklarimi i interesave private dhe i pasurisë.

Ka vetëm një vërejtje për titullin e dispozitës nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Në titull përmendet edhe deklarimi i pasurisë, ndërsa në formulim bëhet fjalë vetëm për konfliktin e interesave, pra deklarimi i interesave private dhe i pasurisë. Punonjësit e Shërbimit janë të detyruar të shmangin çdo konflikt ndërmjet interesave të tyre privatë dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës, të njoftojnë paraprakisht drejtorin e Shërbimit, nëse ai, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, prindërit, motrat e vëllezërit apo fëmijët e tij ndërmarrin veprimtari private apo drejtojnë biznese që mund të çojnë në konflikt interesash, të zbatojnë urdhrat e drejtorit të Shërbimit për parandalimin e konfliktit të interesit, të informojnë dhe të marrin miratimin me shkrim nga drejtori i Shërbimit për çdo veprimtari me apo pa pagesë që kërkojnë të kryejnë jashtë detyrës të tyre në Shërbim, në rastin e drejtorit të Shërbimit, njoftimi paraprak, zgjidhja e konfliktit të interesave dhe miratimi me shkrim për veprimtaritë me, apo pa pagesë janë attribute të ministrit.

Atëherë kemi një qëndrim? Duhet ta themi edhe në këtë nen që punonjësit janë të detyruar? Në fakt, jo të gjithë punonjësit janë të detyruar të deklarojnë pasurinë.

Po, zoti Beja.

**Besmir Beja** – Në fakt, e gjej me vend komentimin e KSHH-së, kështu që në titullin e nenit 49 mund të heqim termin “dhe i pasurisë”, për shkak se këtu qëllimi kryesor ka qenë parandalimi i konfliktit të interesit.

**Ermonela Felaj** – Kush është dakord ta miratojmë nenin 49 siç është, duke hequr nga titulli “pasurinë”, sepse është një detyrim që lind për shkak të një ligji tjetër?

Faleminderit!

Miratohet neni 49 me këtë sugjerim.

Kalojmë te neni 50. Trajtimi financiar gjatë qëndrimit në punë.

Nuk ka vërejtje apo sugjerime për këtë nen.

Kush është dakord? Kundër, apo abstenime nuk ka.

Faleminderit!

Neni 51. Trajtimi financiar suplementar.

Në trajtimin suplementar përfshihen përveç punonjësve që njohim si: Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit, Garda e Republikës, ShISH-i, Policia e Burgjeve, Shërbimi Zjarrfikës të përfshihen punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

Dakord, kjo dispozitë është deklarative.

Kush është dakord? Kundër, apo abstenime nuk ka.

Faleminderit!

Miratohet.

Neni 52.

“Punonjësi i Shërbimit ka të drejtën për pushime vjetore të paguara, si dhe për pushime të tjera me apo pa pagesë, sipas Kodit të Punës. Koha e punës dhe e pushimit njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës shtetërore, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj”.

Nuk ka vërejtje, apo sugjerime.

Kush është dakord?

Faleminderit!

Miratohet.

Neni 53. Leja pa të drejtë page.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka një vërejtje për pikën të nenit 53 të projektligjit thuhet: “Punonjësi i Shërbimit gëzon të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 muaj ose afatgjatë, deri në 2 vjet, dhe një nga pikat është: pas përfundimit të lejes afatgjatë, punonjësi ka të drejtë të kthehet në funksionin që kishte ose në një funksion të barasvlershëm me të”. Pyetja që ngre Komiteti Shqiptar i Helsinkit është: si duhet të veprohet kur nuk gjendet, qoftë dhe përkohësisht funksioni i barasvlershëm me të?

Zoti Beja, zoti Karameta?

**Besmir Beja** – Kjo çështje do të vendoset në listë pritjeje, por rregullohet nga pika 5 ku thuhet: “Rregullat dhe procedurat e lejes pa të drejtë page përcaktohen në Rregulloren e Shërbimit. Pra në Rregulloren e Shërbimit do të përcaktohen edhe rastet se si bëhet kur pozicioni i mëparshëm i punës tashmë është i zënë.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Është e qartë që do ta mbajnë vendin të lirë 2 muaj ose 2 vjet.

Kush është dakord me nenin 53?

Faleminderit!

Miratohet.

Kalojmë te neni 54. Përgjegjësia Disiplinore, Seksioni V.

Shkeljet disiplinore.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është i idesë se lloji i shkeljeve disiplinore të përcaktohet në ligj dhe jo në Rregulloren e Shërbimit dhe të njëjtën ide ka edhe për pikën 7 të nenit pasues. Te shkeljet disiplinore ne gjejmë kategorizimin e shkeljeve, shkelje të lehta, të rënda dhe shumë të rënda, por nuk gjejmë një listë të shkeljeve konkrete. Ndoshta është e pamundur të ketë një listë shteruese të shkeljeve konkrete në detyrë dhe ne, duke mos e njohur natyrën e punës së shërbimit deri një detaje, nuk mund ta bëjmë dot një listë të tillë. Kështu që për oportunitet, unë do të isha që kjo t’i ngelet Rregullores së Shërbimit, sepse është e vetmja që mund të detajojë rast pas rasti çfarë është shkelje, çfarë është shkelje e lehtë dhe çfarë është shkelje shumë e rëndë.

Ndaj kolegë do t’ju ftoja të votojmë për nenin 54 siç është propozuar.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër, apo abstenime nuk ka.

Faleminderit!

Miratohet.

Kalojmë te neni 55. Masat disiplinore.

SHISH-i ka bërë një sugjerim në nenin 55 “Masat disiplinore”, pika 3, shkronja “c/i” ku thuhet se për shkelje shumë të rënda është parashikuar masa disiplinore “largim nga shërbimi”. Gjykojmë se bëhet fjalë për përjashtim, pasi përsëri punonjësi bëhet subjekt i përfitimit financiar të pagesës kalimtare, që parashikon ligji i veçantë i vitit 2009, të cilit i jeni referuar në nenin 51 të këtij projektligji, që është neni i pagesave suplementare.

Zoti Beja, ose zoti Katameta, a mund ta merrni parasysh sugjerimin e SHISH-it që bën sens duke e shtuar një paragraf aty dhe të kujdesemi që këta nuk e marrin pagesën kalimtare?

**Besmir Beja** – Në vlerësimin tim jam shumë dakord që në vend të fjalës “largimi” të vendosim “përjashtimin nga shërbimi”, me qëllim që të evitohet përdorimi i termave të njëjtë me ligjin e posaçëm, që garanton bashkë largimin nga shërbimi dhe pensionin suplementar shtesë. Pra

nuk do të donim që ky të ishte rasti kur pavarësisht se largohet për shkelje disiplinore të përfitojë edhe pension të posaçëm.

**Ermonela Felaj** – Atëherë besoj se propozimi që ofron zoti Beja e plotëson edhe merakun tonë edhe ndërhyrjen që ka barë SHISH-i.

Kush është dakord me këtë nen me ndërhyrjen që bëri zoti Beja që të përdoret fjala “përrjashtim” dhe jo “largim”?

Faleminderit!

Miratohet.

Kalojmë te neni 56. Autoritetet për dhënien e masave disiplinore. Normalisht janë ministri dhe drejtori i shërbimit në varësi të rëndësisë së masës. Kush është dakord me këtë nen?

Miratohet.

Neni 57, "Procesi disiplinor". Ka vetëm një sugjerim nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit për të shqipëruar një shprehje të përdorur në përmbajtjen e ligjit: "Shprehja "për të asistuar" mund të zëvendësohet me fjalët "të jetë i pranishëm" ose "duhet të jetë i pranishëm"". Bëhet fjalë për pikën 4: "Punonjësi, ndaj të cilit ka filluar procesi disiplinor, ka të drejtë të informohet në mënyrë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe shkeljet që mund të vendosen; të formulojë pretendime dhe kërkesa; të njihet me dokumentet e procesit disiplinor dhe të depozitohet prova të mjaftueshme; të ketë të drejtë për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar; të paraqesë dokumente të tjera në mbrojtje të tij". Nuk ka lidhje as me praninë, në fakt. "Të ketë të drejtën për t'u mbrojtur dhe për t'u ndihmuar nga një mbrojtës kryesisht" apo jo?

**Besmir Beja**- "Për t'u përfaqësuar" besoj se do të ishte termi i saktë, pra për t'u përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur prej tij.

**Ermonela Felaj** - Elena.

**Elena Xhina** - Faleminderit!

Në momentin kur themi "të ketë të drejtë për mbrojtje juridike", për mua, i kemi thënë të gjitha dhe nuk ka nevojë ta vazhdojmë më, se kur ke të drejtë për mbrojtje juridike, ke nevojë dhe për të marrë një avokat, për t'u përfaqësuar me prokurë, pa prokurë...

**Ermonela Felaj** - Janë në ligjin "Për ndihmën juridike".

**Elena Xhina** - Po, pra, mjafton të themi: "Të ketë të drejtë për mbrojtje juridike". Nuk ka nevojë ta zgjasim më.

**Ermonela Felaj** - Jam dakord.

Atëherë, kush është dakord me nenin 57, me sugjerimin e bërë për shkronjën "ç", që të hiqet shprehja "dhe të drejtën për t'u asistuar", sipas propozimit të zonjës Xhina? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 58, "Marrja e vendimit". Nuk ka pasur vërejtje për këtë nen. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 59, "Ankimi", pra vazhdon procesi. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 60, "Shuarja e masës disiplinore". Kush është dakord?

Miratohet.

Kreu V, "Dispozita kalimtare dhe të fundit".

Neni 61: "Trajtimi i marrëdhënieve të punës dhe trajtimi ekonomiko-financiar i punonjësve të shërbimit në karrierë, edhe pas ndërprerjes së saj, deri në miratimin e akteve nënligjore përkatëse, të parashikuara në këtë ligj, bëhet sipas dispozitave ekzistuese. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për procedurat disiplinore që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji". A ka ndonjë vërejtje? Nuk ka. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 62, "Aktet nënligjore", bën fjalë për detyrimin që do të ketë ministri i Drejtësisë për të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe afati i propozuar për nxjerrjen e akteve nënligjore është 9 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Vërejtja është në lidhje me afatin. Propozimi nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit është që ky afat të jetë 6 muaj dhe jo 9 muaj.

Ndërkohë, po sipas sugjerimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për nenin 62, "Aktet nënligjore", në nenin 12, pika 1 bëhet fjalë për një udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë, prokurorit të Përgjithshëm, prokurorit të posaçëm dhe jo vetëm për ministrin. Pra, ideja është që nuk është vetëm detyrim i ministrit të Drejtësisë, me sa shoh nga sugjerimi që bën Komiteti Shqiptar i Helsinkit, por nxjerrja e udhëzimeve është dhe detyrim i prokurorit të Përgjithshëm, prokurorit të posaçëm.

Kjo besoj se është një gjë që sistemohet.

Thjesht do të doja të pyesja nëse jemi korrektë me listimin apo ka nevojë ta shohim edhe një herë? Megjithëse do ta shohë edhe Komisioni i Ligjeve.

Zonja Xhina, një qëndrim edhe për afatin, ju lutem!

**Elena Xhina** - Për afatin do të doja të dëgjonim përfaqësuesit e ministrisë, nëse e kanë apo jo të mjaftueshëm, ndërsa për sa u përket listimeve, ia lëmë detyrë Komisionit të Ligjeve t'i rishikojë edhe një herë dispozitat dhe institucionet që janë të detyruara për të nxjerrë akte nënligjore.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Zoti Beja?

**Besmir Beja** - Sa i takon afatit, do të kërkoja mirëkuptimin tuaj për të qenë në versionin që është propozuar, edhe duke pasur në konsideratë që një pjesë e mirë e akteve, që rregullojnë tashmë veprimtarinë e shërbimit, janë në fuqi, por, nga ana tjetër, të jemi të sinqertë, ka dhe një mbingarkesë Ministria e Drejtësisë, për shkak të të gjitha akteve që janë miratuar në këtë periudhë me miratimin e akteve nënligjore. Kështu që do të kërkoja mirëkuptimin tuaj që afati të ishte ashtu siç është propozuar.

**Ermonela Felaj** - Dakord.

Faleminderit!

A ka propozime të tjera? Nuk ka.

Edhe unë do të isha dakord të ruajmë propozimin e bërë për këtë dispozitë nga Ministria e Drejtësisë. Ndërkohë, të them të drejtën, afati 9-mujor më duket pak i gjatë në raport me gjithë gjënë që është bërë deri tani për të ardhur tek ky ligj dhe te miratimi i tij. Kështu që në momentin kur ne po miratojmë një ligj në përfundim të legjislaturës, duke krijuar një shërbim pothuajse të ri, në kuptimin e funksionimit, përmbajtjes dhe zgjerimit të aktivitetit të tij, bie pak ndesh me momentin e gjatë, pra pothuajse edhe një vit nga momenti kur të bëhet tërësisht efektiv për kryerjen e detyrave të veta. Stonon pak. Kështu që do të isha për përgjysmimin e kësaj kohe.

A jeni dakord t'i propozojmë Komisionit të Ligjeve të rishikojë kohën e nxjerrjes së akteve nënligjore? Gjithmonë, sipas këtij arsytimi.

Faleminderit!

Kalojmë në nenin 63, "Shfuqizime". Kush është dakord?

Faleminderit!

Neni i fundit është neni 64, "Hyrja në fuqi". Ligji parashikohet të hyjë në fuqi në afatin e zakonshëm. Kush është dakord?

Miratohet.

Ftoj kolegët, Artemisin, Nimetin dhe Benin të jenë dhe me figurë, që të miratojmë në tërësi

ligjin e ri që propozohet "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale". Ju lutem, kolegë, zoti Elezi, zonja Malo, zoti Murrizi, nëse na dëgjoni, bëni akses me figurë për miratimin në tërësi!

Me miratimin e këtij projektligji do të mbyllim edhe mbledhjen e ditës së sotme.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të ligjit "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale"? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Shumë faleminderit, kolegë!

Miratohet.

Realisht, ju falënderoj për angazhimin në ditën e sotme, sepse, në fakt, ishte pak ditë e gjatë!

Ndërkohë, ju njoftoj se do të kemi dhe një mbledhje nesër për ligjin për artikujt piroteknikë, me qëllim që javën tjetër të jeni më të disponueshëm ndaj pjesës tjetër të aktivitetit tonë, që nuk zhvillohet në zyrat e Kryesisë së Kuvendit.

Faleminderit, zoti Karameta!

Faleminderit, zoti Beja!

Punë të mbarë të gjithëve!

## **MBYLLET MBLEDHJA**